



# Seminaret Rajonale të Trashëgimisë 2012-2013

Libërthi i folësve dhe konspekteve

Menaxhimi i trashëgimisë  
kulturore: Menaxhimi  
frymëzues dhe përçasjet  
(Gjirokastër, shtator 2012)

Histori të së shkuarës dhe  
kujtime të së ardhmes  
(Prizren, tetor 2013)

CH  
WB

Cultural  
Heritage without Borders

KULTURARV UTAN GRÄNSER



# **Seminaret Rajonale të Trashëgimisë 2012-2013**

Libërthi i folësve dhe konspekteve

Menaxhimi i trashëgimisë  
kulturore: Menaxhimi  
frymëzues dhe përqsjet  
(Gjirokastër, shtator 2012)

Histori të së shkuarës dhe  
kujtime të së ardhmes  
(Prizren, tetor 2013)

## Rreth këtij libërthi

Ky libërth sjell për lexuesin një përzgjedhje konspektesh nga Seminaret e Trashëgimisë Rajonale të mbajtur në Gjirokastër, në shtator 2012 (Menaxhimi i trashëgimisë kulturore: Menaxhimi frymëzues dhe përqasjet) dhe në Prizren, në tetor 2013 (Histori të së shkuarës dhe kujtime të së ardhmes). Konspektet, shumë prej të cilave janë përgatitur posaçërisht për këtë libërth, janë renditur sipas tri kategorive që pasqyrojnë temat e diskutimeve të mbajtura në të dy seminarat.

Ky publikim është mundësuar falë mbështetjes së Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është nën përgjegjësinë e vetmë të autorëve dhe nuk reflekton në asnjë moment pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB)

Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) është një organizatë e pavarur joqeveritare suedeze e themeluar më 1995 si përgjigje ndaj shkatërrimit të trashëgimisë kulturore në Bosnje-Hercegovinë dhe punon për pajtimin dhe rindërtimin e këtij vendi që nga përfundimi i luftës në 1995-ën.

Me kalimin e kohës, CHwB-ja e zgjeroi veprimtarinë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përmes punës dhe veprimtarive të mbështetura në parimet e pajtimit, restaurimit dhe ri-integrimit. Veç selisë qendrore në Stokholm, CHwB-ja ka tri zyra lokale në Ballkan: në Bosnje-Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Që nga krijimi i saj, CHwB ka restauruar më tepër se 19 monumente të rëndësishme kombëtare në Bosnje-Hercegovinë, 40 në Kosovë dhe 20 në Shqipëri, si dhe muret fortifikuese të qytetit të Kotorrit në Malin e zi dhe çatitë e kishave, hauret mesjetare, mullinjtë e qilarët e verës në Serbi. Përveç punëve restauruese, CHwB-ja ka krijuar dy rrjete të rëndësishme rajonale në Ballkan: (1) Rrjeti i Muzeve të Ballkanit, i cili bën bashkë muze të ndryshme në Ballkan përmes programeve të përbashkëta për nxitjen e qasjeve, përfshirjes, profesionalizmit dhe ekspozitave cilësore; dhe (2) Rrjeti i OJQ-ve për Trashëgiminë në Europën Jug-Lindore, i cili bashkon OJF-të kryesore lokale që punojnë në fushën e trashëgimisë

kulturore në Ballkan përmes nismave të përbashkëta. Veç kësaj, nisma e CHwB-së për Bashkëpunimin Rajonal për Trajnimin është përgjegjëse si për Kampet Rajonale të Restaurimit, ashtu dhe për Seminaret Rajonale, të cilat ofrojnë mundësi për studentët dhe profesionistët e rinj që të mësojnë nga ekspertët dhe mjeshtrat e të punojnë drejt-përdrejt me monumentet dhe vendet e trashëgimisë. Mbështetja financiare për CHwB-në vjen kryesisht nga Suedia, ndërsa financime shtesë kanë ardhur dhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Komisioni Evropian, e të tjerë.

Vizioni i CHwB-së është se trashëgimia kulturore është një forcë e natyrshme dhe aktive në pajtimin, zhvillimin social dhe ekonomik dhe forcimin e të drejtave të njeriut. Misioni ynë është të forcojmë shoqërinë civile përmes projekteve dhe programeve lokale e rajonale të trashëgimisë kulturore në fushat e prekura nga konflikti dhe/ose në nevojë për ndihmë pas katastrofave apo për zhvillim.

## Pasqyra e lëndës

Folësit e seminareve **[ 8 ]**

Hyrje **[ 20 ]**

### Vende dhe kujtime

Arkeologjia dhe roli i saj në një botë në ndryshim **Nga Lorenc Bejko [ 24 ]**

Amfiteatri romak i Durrësit, një vend i pazbuluar arkeologjik me të ardhme potenciale turistike **Nga Armada Molla [ 29 ]**

Hydrocentrali Prizrenasja: një vështrim i shkurtër mbi historikun e ndërtimit **Nga Nora Arapi Krasniqi [ 31 ]**

Ripërdorimi i mjediseve të dikurshme industriale: vëzhgime nga pikëpamja e ruajtjes **Nga Bosse Lagerqvist [ 34 ]**

Historitë janë bërë për t’u treguar **Nga David Perrin [ 39 ]**

### Trashëgimia dhe bashkësitë

Panel diskutimi- si i lidh trashëgimia njerëzit? **Nga Diana Walters [ 44 ]**

Trashëgimia si katalizator për zhvillimin e qëndrueshëm **Nga Daniel Laven [ 46 ]**  
Integriteti vizual dhe trashëgimia kulturore **Nga Ekphrasis Studio (Blerina Berber, Kevin Tummers) [ 54 ]**

Nga ndërhyrja shpëtuese te biznesi social: zhvillimi i një përqasjeje të integruar për të shpëtuar qytetin e gurtë

**Nga Sadi Petrela [ 56 ]**

Trashëgimia dhe turizmi në Ballkan: a është trashëgimia një kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për turizmin në Ballkan?

**Nga David Prince [ 60 ]**

Thesari im sekret: të lidhësh komunitetin, trashëgiminë dhe muzetë **Nga Visnja Kisic [ 64 ]**

Reflektime mbi Kampin e 15-të Rajonal të Restaurimit në Kosovë **Nga Stefanie White [ 66 ]**

### Trashëgimia dhe përqasjet frymëzuese

Muzetë dhe të drejtat e njeriut **Nga David Fleming [ 70 ]**

Bujtinë dhe Bunker **Nga Endrit Marku [ 72 ]**

Muze për të gjithë **Nga Tatjana Mijatovic [ 74 ]**

Tour de Culture **Nga Enes Toska [ 78 ]**

## Folësit



*Dr. Aliriza Arënliu | Asistent profesor në Departamentin e Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës, Kosovë dhe bashkëthemelues i Dokufestit, Kosovë*

DOKUFEST, Festivali Ndërkombëtar i Dokumentarit dhe Film-it të Shkurtër, është ngjarja më e madhe kinematografike në Kosovë. Festivali organizohet në Gusht në qytetin piktoresk dhe historik të Prizrenit, i cili tërheq artistë të shumtë rajonalë dhe ndërkombëtarë. Në këtë festival të përvitshëm, filmat shfaqen dy herë në ditë në tri kinema të hapura si dhe në dy kinema të rregullta. Përveç filmave, festivali njihet për netët e gjalla pas shfaqjeve. Në kuadrin e festivalit organizohen disa ngjarje: seminare, ekspozita DokuFoto, festival kamping, koncerte, të cilat e kthejnë qytetin në një vend mjaft të këndshëm.

Aliriza Arënliu është asistent profesor në Departamentin e Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës që nga viti 2001 dhe mban gradën PhD në psikologji nga Universiteti Ludwig Maximilian i Mynihut, si dhe gradat BA dhe MA nga Universiteti Bogaziçi, Stamboll, në këshillim psikologjik. Puna e tij kërkimore dhe interesat përqëndrohen te rreziqet dhe faktorët mbrojtës të shoqëruar me sjelljen vetëvrasëse mes adoleshentëve, struk-

tura e faktorit të personalitetit me fokus studimin psikoleksikal të personalitetit, emocionet dhe rritje post-traumatike. Veç këtyre, Aliriza Arënliu punon si këshillues i pavarur në projekte kërkimore, më së shumti në sondazhe opinionesh dhe projekte vlerësimesh. Deri në vitin 2008, z. Arënliu punonte si nëpunës shtetëror profesionist i shëndetit mendor në zyrën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Prishtinë. Aliriza Arënliu ka qenë edhe drejtor ekzekutiv dhe një nga themeluesit e Dokufestit, ku ka shërbyer si drejtor ekzekutiv deri në vitin 2012.



*Alisa Gojani | Kuratore, Muzeu i Kosovës, Kosovë*

Alisa Gojani filloi të punonte në Muzeun e Kosovës në vitin 2006, dy vitet e para si cicerone në Muzeun Etnologjik dhe më pas kaloi në Muzeun e Kosovës në vitin

2008 (deri më sot) si kuratore e ekspozitave. Që nga punësimi në muze, ka marrë pjesë në shumë seminare, vizita studimore dhe programe ndërkombëtare për administrimin e muzeve. Alisa është përfshirë në ngritjen e ekspozitave të muzeve si dhe në krijimin e programeve ndërvepruese edukative për fëmijë, studentë dhe njerëz me nevoja të veçanta, siç janë programet

“ABC-ja e trashëgimisë kulturore” dhe “Muzeu i lëvizshëm”. Këto veprimtari kanë rritur aftësinë e paraqitjes në Muzeun e Kosovës, ndërsa metodat moderne kanë rritur numrin e vizitorëve në muze.



*Armada Molla | Kryetare e Shoqatës së Zhvillimit të Turizmit Kulturor, Shqipëri*

Armada Molla ka përvojë të gjerë në sektorin e trashëgimisë dhe turizmit. Mban gradën Master (2009-2011) në trashëgimi kulturore dhe diplomë universitare në Histori-Gjeografi (1991-1995). Karriera në fushën e trashëgimisë kulturore përfshin një periudhë të gjatë pune (2003-2009) si specialiste muzeu/lektore në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë, ku ka ndjekur dhe mjaft trajnime dhe seminare mbi muzetë. Gjatë viti të fundit të punës në muze, Armada ishte bashkautore e tekstit të udhërrëfyesit zanor shqip-anglisht për muzeun, një projekt i përbashkët i PNUD-Shqipëri dhe Muzeut Historik Kombëtar. Që nga viti 2006 Armada është përfshirë në projekte të ndryshme mbi turizmin kulturor në Shqipëri. Gjatë viteve 2010-2012, ka

punuar si koordinatore projekti për Shoqatën Shqiptare të Turizmit, përgjegjëse në veçanti për Çmimin Shqiptar të Turizmit.

Ka botuar disa artikuj mbi tema si muzeologjia, trashëgimia dhe destinacionet turistike. Aktualisht po punon për një botim për prirjet e reja dhe mjetet për zhvillimin kulturor në Shqipëri. Ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare dhe seminare në Evropë dhe në Ballkan mbi çështjet e turizmit, në veçanti për turizmin kulturor, muzeologjinë dhe mbrojtjen e promovimin e trashëgimisë kulturore.



*Blerina Berberi dhe Kevin Tummers | Studio Ekphrasis, Tiranë, Shqipëri*

Studioja Ekphrasis është një nismë për zhvillimin kulturor dhe krijues në Shqipëri dhe jashtë saj. Pikat kryesore të veprimtarisë së saj përfshijnë kërkimin dhe vlerësimin e politikave kulturore, angazhimin dhe ndërgjegjësimin e individëve dhe bashkësive mbi artet, njohjen ligjore të statusit të artistëve dhe krijuesve të pavarur në Shqipëri dhe rritjen e cilësisë artistike të jetës për popullatën në përgjithësi. Studioja Ekphrasis është regjistruar

në Shqipëri që nga viti 2009 dhe ka punuar në mënyrë të pavarur mbi një varg projektsh kulturore e artistike me partnerë shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Kevin Tummers dhe Blerina Berberi kanë të dy grada Master në Art dhe Trashëgimi: Politikë, Administrim dhe Edukim nga Universiteti i Maastrichtit, Holandë.



*Bosse Lagerqvist | Shef i Departamentit të Konservimit, Universiteti i Gothenburgut, Suedi*

Bosse Lagerqvist është Shef i Departamentit të Konservimit në Universitetin e Gothenburgut (UG).

Gradën universitare e ka marrë në programin Konservim i Integruar e Mjediseve të Ndërtuara, UG, ndërsa gradën e Doktoraturës në Konservim, UG, me një disertacion në vitin 1997 për fotogrametrinë dhe menaxhimin e informacionit. Studimet e tij gjatë viteve kanë pasur të bëjnë me metodat për dokumentimin dhe regjistrimin e vetive fizike të trashëgimisë, trashëgiminë industriale dhe mundësitë e zhvillimit të tyre në dobi të zhvillimit të vazhdueshëm shoqëror, dhe trashëgimia detare - si ajo mbi ujë ashtu edhe bashkësitë bregdetare - dhe problemet e tyre, por edhe me mundësitë e përfshirjes së tyre në praktikat e trashëgimisë. Në vitet 2004-2009, ka punuar me kohë të pjesshme në organizatën e trashëgimisë publike të

rajonit të Suedisë Perëndimore me çështje që kishin të bënin me trashëgiminë industriale dhe zhvillimin shoqëror në nivel rajonal. Është anëtar i bordit të Shoqatës Suedeze të Trashëgimisë Industriale, dhe i Komitetit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Trashëgimisë Industriale (TICCIH).



*Dr. Daniel Laven | Instituti Evropian i Kërkimeve për Turizmin (ETOUR), Universiteti Mid Sweden dhe në Departamentin e Konservimit, Universiteti Gothenburg, Suedi*

Daniel Laven është profesor i asociuar në departamentin e studimeve për turizmin dhe gjeografinë në Universitetin Mid Sweden dhe partner kërkimor në Institutin universitar evropian të kërkimeve për turizmin (ETOUR). Danieli koordinon programin Master të departamentit ndërsa studimet e tij trajtojnë çështje të zhvillimit të qëndrueshëm me fokus peizazhin, trashëgiminë dhe zonat e mbrojtura. Danieli bën pjesë edhe në Qendrën universitare të Kërkimeve për Rreziqet dhe Krizat dhe së fundi ka përfunduar një studim në departamentin e Konservimit në Universitetin Gothenburg.

Para se të futej në Universitetin Mid Sweden, Danieli punonte për Shërbimin Kombëtar Amerikan të Parqeve, duke e ndarë kohën mes Institutit të Studimeve për Konservimin (si

shkencëtar në praktikë i shkencave sociale) dhe Parkut Kombëtar Historik Marsh - Billings - Rockefeller (si asistent menaxher i zonës së mbrojtur) - që të dyja këto vende në Woodstock, Vermont (ShBA). Gjatë kësaj kohe, ka qenë dhe asistent profesor zëvendësues në Shkollën e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore Rubenstein, Universiteti i Vermontit. Danieli i ka kryer studimet në Universitetin Wisconsin-Madison (filozofi), si dhe gradat Master (planifikimi i burimeve natyrore) dhe Doktoraturë (burime natyrore) nga Universiteti i Vermontit.



*Dr. David Fleming | Drejtor, Muzetë Kombëtarë, Liverpool, Mbretëria e Bashkuar*

Profesori David Fleming, PBE, MA, PhD, AMA, u bë drejtor i Muzeve Kombëtare të Liverpoolit në vitin 2001. Qysh me mbërritjen e tij, mbikëqyri përmbylljen e disa projekteve të mëdha përfshi projektin 45 milionë sterlina "Drejt së ardhmes" i cili parashikonte rinovimin e Galerisë së Artit Walker dhe të Muzeut Botëror, si dhe hapjen e Muzeut Kombëtar të Skllavërisë. Së fundi ka mbikëqyruar krijimin dhe hapjen e muzeut të ri të Liverpoolit prej 75 milionë sterlinash, fitues i Çmimit të Këshillit të Evropës për Muzetë për vitin 2013. Që kur u bë drejtor i Muzeve Kombëtare të Liverpoolit, vizitorët u katërfishuan, nga 700,000 në vit,

në më tepër se 3.2 milionë. Para mbërritjes në Liverpool, Davidi ishte për 11 vjet drejtor i Muzeve Tyne dhe Wear që kanë fituar shumë çmime, ku drejtonte ekipet që kryenin zhvillimet kryesore kapitale (përfshi Muzeun Newcastle Discovery, Muzeun Sunderland dhe Muzeun e Kështjellës Romake Winter Gardens dhe Segedunum) dhe arriti të rriste numrin e vizitorëve. Para kësaj, ishte kujdestari kryesor i Muzeve Hull, ku projekti i tij më i madh përfshinte një muze të ri për transportin, Shkollën e Vjetër Fillore dhe Muzeun Hull and East Riding. Karrierën në fushën e muzeve e nisi si themelues dhe kurator i Muzeut të Fermës në Yorkshire, York. Davidi ka qenë edhe president i Shoqatës Britanike të Muzeve, ish-kujdestar i Muzeut Kombëtar të Futbollit dhe ka shërbyer në disa komisione dhe projekte qeveritare. Bën pjesë në një numër bordesh dhe trupash drejtuese, si për shembull: organizator në Aleancën e Muzeve të Drejtësisë Sociale; Kryetar në Komisioni ICOM të Financave dhe Burimeve; Drejtor thesari dhe zëvendëspresident në Forumin Evropian të Muzeve, Profesor i jashtëm i Studimeve Muzeale, Universiteti Hope Liverpool; Këshilltar i posaçëm i Muzeut të Demokracisë, Rosario, Argjentinë; Kujdestar i projektit St James in the City, Liverpool; Kryetar i Grupit të Kryebashkiakëve të Liverpoolit për Trashëgiminë Kulturore; President themelues i Federatës së Muzeve të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut; Zëvendëspresident i Bordit të Shoqatës së Muzeve Britanikë; Anëtar i Grupit Steering, Liverpooli Vend i Trashëgimisë Botërore. Davidi ka

botuar mjaft materiale dhe ka dhënë leksione anembanë botës, në pothuajse gjashtëdhjetë qytete në dyzet vende të ndryshme mbi administrimin e muzeve dhe drejtimin e tyre, mbi muzetë historikë të qyteteve, përfshirjen sociale dhe të drejtat e njeriut.



*David Perrin | Konsulent për hulumtimin e tregut dhe marketing, Mbretëri e Bashkuar/Suedi*

David Perrin është një studiues tregu dhe këshilltar marketingu me fokus trashëgiminë dhe zhvillimin. Është përqendruar kryesisht në vendet apo rajonet që jetojnë ose janë prekur nga konfliktet, ku përpiqet ta përdorë trashëgiminë si mjet në procesin e vendosjes së paqes dhe ripajimit. Veç punës këshillimore, është fotograf dhe bloger.

Para se të punonte si i pavarur, Davidi ka punuar për 18 vjet si këshilltar kryesor për IMS/Medical Radar ku ishte përgjegjës për krijimin e platformave kryesore të studimeve të tregut për industrinë farmaceutike, punë që çoi në evidentimin e rëndësisë së këshillimit strategjik të marketingut mbështetur te provat. Ka një gradë nderi në politikë dhe qeverisje nga Universiteti Kent, Canterbury dhe planifikon të nisë studimet në vitin 2014. Davidi është me origjinë nga Britania dhe jeton në Gothenburg, Suedi që prej vitit 1995. Si pasion ka ushqimin, leximin dhe muzikën.



*Dr. David Prince | Prince + Pearce, Projekti i Planifikimit Kulturor, Mbretëri e Bashkuar*

Dr. David Prince është psikolog me më tepër se tridhjetë vjet përvojë në planifikimin strategjik në sektorin kulturor. Pas universitetit, në vitin 1983, themeloi firmën këshilluese-studimore Prince, e cila punon për klientë nga sektorët publikë dhe privatë në Mbretërinë e Bashkuar, Evropë, Lindjen e Mesme, Lindjen e Largët, Amerikën e Jugut dhe SHBA, ku ka përbushur me sukses mbi 5,000 kontrata.

Në vitin 2010, bashkoi forcat me arkitektin Simon Pearce dhe formuan planin e projekteve kulturore Prince +Pearce për të këshilluar klientët në programet kulturore në formulimin e strategjive kombëtare, ofrimin e shërbimeve publike apo përmirësimin e performancës së korporatave. Është partner studimor i Universitetit College të Londrës dhe partner i Shoqatës Mbretërore Gjeografike. Aktualisht punon me një varg projektsh në Mbretërinë e Bashkuar dhe në shtetet e Gjirit Persik në Lindjen e Mesme.



*Dr Diana Walters | Koordinatore e Muzeve Rajonale, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Suedi*

Diana Walters punon si këshilltare ndërkombëtare mbi muzetë dhe trashëgiminë e specializuar në përfaqshjen, pjesëmarrjen dhe dialogun ndërkulturor, edukimin, administrimin dhe zhvillimin profesional. Me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, ka punuar në mbi 20 vende si administratore projektsh, ndërmjetëse, studiuese dhe lektore. Ka qenë drejtoreshë e Masterit Ndërkombëtar të studimeve mbi muzetë në Universitetin e Gothenburgut. Diana aktualisht jeton në Suedi dhe punon me kohë të pjesshme për OJQ-në Trashëgimia Kulturore pa Kufij me orientim muzetë dhe interpretimin e zhvillimit në Ballkanin perëndimor dhe vende të tjera në tranzicion. Mban gradën PhD nga Universiteti i Newcastle.



*Elizabeth Gowing | Shkrimtare udhëtuese e pavarur dhe këshilluese, Mbretëri e Bashkuar*

Elizabeth Gowing është një nga bashkëthemelueset e OJQ-së jofitimprurëse The Ideas Partnership, e cila e ka përqendruar fuqinë e vullnetarëve në Kosovë për të trajtuar sfidat mjedisore, arsimin dhe trashëgiminë kulturore dhe mbështetjen për popullatën rome, ashkali dhe egjiptiane në Fushë-Kosovë. Përvojat dhe aventurat e Elizabethës në Kosovë

që nga viti 2006 e kanë frymëzuar për një varg shkrimesh. Libri i saj më i ri, “Edith dhe unë” ndjek në Kosovë gjurmët e udhëtares, antropologes, punonjëses humanitare dhe aventurieres së guximshme Edith Durham. Librat e saj të mëparshëm “Udhëtime në gjak e mjaltë”, “Si të bëhesh bletëritës në Kosovë” dhe “Libri i vogël i mjaltit” dokumentojnë përvojat e saj nga jeta dhe prodhimi i mjaltit në Kosovë. Elizabetha shkruan periodikisht edhe poezi si dhe artikuj mbi jetën dhe kulturën në Kosovë.



*Endrit Marku | Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Universiteti Polis, Tiranë, Shqipëri*

Endrit Marku është arkitekt. E mori gradën Master Shkencor në Arkitekturë nga universiteti i Romës “La Sapienza”. Që atëherë,

është angazhuar si staf akademik në Universitetin POLIS, Tiranë, dhe si arkitekt profesionist në studion e dizajnit Metro\_POLIS. Endriti ka përvojë të qëndrueshme në shumë fusha të zbatuara të dizajnit, si dizajn arkitekturor, dizajn i brendshëm, planifikim urban, dizajn dhe planifikim urban. Ka qenë tepër aktiv në programe ndërkombëtare të shkëmbimeve akademike dhe në projekte me bazë vendore dhe ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në disa konkurse ndërkombëtare arkitekture, konferenca dhe simpoziume shkencore. Endriti është autor i artikujve dhe botimeve të ndryshme.



*Enes Toska | Arkitekt dhe administrator projekti, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Kosovë*

Enesi nisi të punojë me CHwB-në në vitin 2002, me seminare mbi trashëgiminë kulturore dhe konservimin e integruar. Më pas u përfshi më tepër në punën me projekte pilot dhe plane zhvillimi si administrator programi për Programin e Rehabilitimit të Zonës Historike të Prizrenit dhe si arkitekt për restaurimin e Kullës Mazrekaj në Drenoc. Nga viti 2005 deri në 2008 ka qenë administrator projekti në Planet Pilot për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Isniqit, Drenocit dhe Deçanit dhe ka punuar në Planin e Ruajtjes dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, si dhe në planet bashkiake të zhvillimit, planet e zhvillimit urban dhe planet rregullatore urbane për Junikun. Është angazhuar për një periudhë të gjatë në proceset e vendimmarrjes urbane dhe hapësinore, duke marrë pjesë në seminare disa ditore kushtuar Prizrenit, Junikut, Mamushës, Hanit të Elezit, Bushtrrisë, Gjakovës dhe Parteshit. Angazhime të tjera tepër të rëndësishme dhe pasionante të tij përfshijnë Tour de Culture dhe sidomos punën me grupe të ndryshme të bashkësive lidhur me ndërgjegjësimin për trashëgiminë kulturore dhe projekte promovuese.



*Lejla Hadžić | Koordinatore rajonale, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Shqipëri / Bosnje-Hercegovinë*

Lejla Haxhiç është arsimuar si arkitekte konservatore në Academia Istropolitana Nova.

Në këtë cilësi, ka hartuar projekte të plota restauruese dhe ka trajnuar arkitektë në fushën e restaurimit/konservimit (që nisin nga teknikat vëzhguese deri te zbatimi dhe mbikëqyrja e cilësisë për restaurimet), në bashkëpunim me Trashëgiminë Kulturore pa Kufij (CHwB), institucione shtetërore në Bosnje-Hercegovinë dhe në Shqipëri, si dhe me individë që kanë dashur të restaurojnë/konservojnë monumente në zotërim të tyre. Këto punime janë kryer në një larmi ndërtesash, që nga monumentet e kultit deri te rezidencat e banimit, kështjellat, trashëgimi vernakulare apo industriale, ku një nga objektivat kryesore veç restaurimit ka qenë edhe shndërrimi i tyre në monumente me përdorim të qëndrueshëm.

Që nga viti 2006, Lejla është koordinatore rajonale për CHwB-në, ku kujdeset për zbatimin e restaurimeve dhe projekteve zhvillimore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këto projekte janë hartuar në mënyrë të tillë që të shërbejnë si mundësi për trajnime edhe mbi materialet dhe teknikat tradicionale. Ajo është

nismëtare për një varg veprimtarish, si ndërgjegjësimi publik (zhvillimi dhe shfaqja e ekspozitave të ndryshme) deri te krijimi i rrjetit rajonal të OJQ-ve në Evropën Jug-Lindore për të vënë në zbatim propozime të ndryshme projektesh nga një larmi e madhe donatorësh.



*Dr. Lorenc Bejko | Profesor i arkeologjisë dhe administrimit të trashëgimisë kulturore, Universiteti i Tiranës, Shqipëri*

Lorenc Bejko është profesor i arkeologjisë dhe administrimit të trashëgimisë kulturore në Universitetin e Tiranës. Më herët ka drejtuar sektorin e konservimit arkeologjik në Qendrën Ndërkombëtare për Arkeologjinë Shqiptare dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës në Ministrinë e Kulturës në Shqipëri. Është specializuar në arkeologjinë prehistorike dhe në fusha si arkeologji peizazhi, arkeologji teorike, zakone mortore, ruajtje dhe administrim arkeologjik. Lorenci ka marrë pjesë intensive në gërmime në Shqipëri dhe Itali dhe është përfshirë në shumë projekte konservimi.



*Nora Arapi Krasniqi | Zyrtare për administrimin e integruar, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kosovë*

Nora i përfundoi studimet për arkeologji në Prishtinë dhe vazhdoi studimet e nivelit Master në Katholieke Universiteit

në Leuven, Belgjikë, ku ndoqi edhe programin Konservimi i Monumenteve dhe Vendeve Arkeologjike. Përvoja e saj në fushën e trashëgimisë kulturore nisi me përfshirjen në zyrën e CHwB- së në Kosovë në vitin 2009 si asistente programi, çka pasoi me pozicionin e administratores së projektit dhe si bashkëpunëtorë e jashtëm. Është përfshirë në projekte të ndryshme në kuadër të programit të CHwB-së, duke nisur nga konservimi i integruar, projekte restauruese dhe mbrojtëse, projekte të promovimit të turizmit kulturor, dhe më pas kaloi në rolin e koordinatores lokale për Planet Lokale të Trashëgimisë.

Pasi mbaroi programin Master në Belgjikë, nisi punë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në departamentin e trashëgimisë Kulturore, si zyrtare për administrimin e integruar. U përfshi në disa projekte të trashëgimisë kulturore, përfshi restaurimin e hidrocentralit Prizrenasja, pranë Prizrenit; restaurimin e shtëpisë tradicionale të gurtë në Zym; hartimin e udhër-



rëfyesit “Prizreni në xhepin tuaj”; zbatimin e Planit të Ruajtjes dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit dhe projektin e Këshillit të Evropës “Promovimi i Shumëllojshmërisë Kulturore të Kosovës”. Veç angazhimit si arkitekte konservatore, ka punuar gjatë viteve 2012-2013 si asistente në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Inxhinierisë Civile dhe Arkitekturës, në Departamentin e Historisë Arkitekturore dhe Trashëgimisë së Ndërtimeve.



*Sadi Petrela | Drejtor, Fondacioni Gjirokastra, Shqipëri*

Sadi Petrela është drejtori ekzekutiv i Fondacionit Gjirokastra që nga viti 2006, një periudhë ndryshimesh të shpejta dhe zhvillimesh në punën e organizatës. Ish gazetar, ka përvojë tepër të pasur në bashkërendimin e një mori projektsh të ndërlikuara si dhe në punën me bashkësinë vendore.



*Sali Shoshi | Shef i zyrës Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Kosovë*

Sali Shoshi është një arkitekt i ri nga Kosova. Si shef i zyrës CHwB në Kosovë është përfshirë në disa projekte të ruajtjes së trashëgimisë kulturore në vend. Gjithashtu është një zë publik aktiv për shoqërinë civi-

le në Kosovë. Pasionet e tjera të Saliut janë ngjitja në mal dhe biçikleta. Është i martuar dhe ka dy fëmijë.


Në këtë konferencë u ftua të fliste rreth identitetit. Si një njeri që është rritur në Kosovë në fund të shekullit të njëzetë (gjatë dramës së Kosovës), ai e sheh identitetin dhe identitetet si tepër të sforcuara dhe të mbishprehura por edhe të brishta dhe drithëruese, gjithnjë të kontrolluara e të ndërtuara.



*Stefanie White | Konservuese, Irlanda Veriore*

Stefanie White është diplomuar nga Universiteti St. Andrews me Master në historinë e lashtë dhe pasi ka përfunduar një Master pasuniversitar në Queen's University, Belfast, u specializua në konservimin e objekteve në Univesitetin Cardiff, Uells. Gjashtë vitet e fundit ka punuar në konservimin praktik të objekteve dhe konservim parandalues në muze si dhe në mjediset arkeologjike dhe të trashëgimisë. Ka dhënë kurse për ruajtjen e trashëgimisë në Mbretërinë e Bashkuar, Irlandë, Greqi dhe, si vullnetare për Trashëgiminë pa Kufij në Turkmenistan, Shqipëri dhe, së fundi, në Kosovë. Aktualisht punon për “Antarctic Heritage Trust”. Nga janari në shtator 2013, e kaloi stinën e dimrit në Antarktidë me konservimin e objekteve historike të lëna nga eksploruesit. Në janar 2014 ka planifikuar kthimin në Antarktidë

për konservimin e objekteve të lëna nga Shackleton dhe Scott. Lista më e re e artikujve të botuar përfshin “Ruajtja e mumies egjiptiane dhe qefinit”, “Ruajtja e polikromeve egjiptiane”, “Ruajtja e Burnham Hoard” dhe “Projekti Merv”.



*Tatjana Mijatović | Departamenti i Arkeologjisë, Muzeu Kombëtar i Bosnje- Hercegovinës, Bosnje-Hercegovinë*

Tatjana Mijatović BA, Ing. Arch. ka lindur në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë, ku edhe ka kryer studimet Master në

Fakultetin e Arkitekturës. Nga viti 2002 deri më 2006, punoi si bashkëpunëtorë në Muzeun Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës ku dokumentonte gërmimet arkeologjike. Nga viti 2006 Tatjana ka punuar me kohë të plotë në sektorin e dokumentimit në Departamentin Arkeologjik të Muzeut Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës. Puna e saj ka të bëjë me hartimin e dokumentacionit të hollësishëm 3D dhe 2D për ndërtesat historike dhe vendet arkeologjike, me skicimin e ekspozitave të përkohshme, dizajnin grafik (për libra, posterë, broshura informuese, etj.) me skicimin e objekteve të muzeut dhe përgatitjen e botimeve të ndryshme. Ka punuar edhe me projekte për ruajtjen e restaurimin e monumenteve kombëtare si bashkëpunëtorë e Institutit Kantonal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Historike dhe Natyrore të Sarajevës.




*Vishnja Kisić | Sekretare e Përgjithshme, Europa Nostra, Serbi*

Interesat e Vishnja Kisićit janë përqendruar te menaxhimi i trashëgimisë dhe interpretimi në njërën anë dhe te aktivizmi, vullnetarizmi, të mësuarit, zhvillimi

social dhe njerëzor në anën tjetër. Synimi i saj më i madh është ta bëjë botën një vend me më tepër kuptim, përgjegjësi dhe gëzim për të jetuar. Si historiane arti, muzeologe dhe administratore arti, përpiqet të kontribuojë duke e përdorur trashëgiminë për të rritur kuptueshmërinë mes njerëzve.

Vishnja po kryen studimet PhD me temën “Menaxhimi strategjik i trashëgimisë si model gjenerimi vlerash për shoqërinë” në Fakultetin e Filozofisë ku jep edhe mësim lëndën e administrimit të trashëgimisë, ndërkohë që është e përfshirë në studime në Qendrën për Muzeologji dhe Trashëgimi. Është angazhuar në mënyrë aktive në sektorin civil si sekretare e përgjithshme e Europa Nostra në Serbi dhe administratore e disa nismave të lidhura me trashëgiminë: projekti rajonal Angazhimi i shoqërisë civile në trashëgimi, faqja e internetit dhe platforma e bashkëpunimit Herity Fair, si dhe në programin edukativ për fëmijët “Shijoj dhe mbroj”. Vishnja e merr frymëzimin nga njerëzit dhe vendet në të gjithë botën. Mjediset ndërkombëtare si Muzeu i Artit dhe Arkeologjisë, Kolumbi, Koleksioni Peggy Guggenheim, Bialja e Venecias ose Europa Nostra ku ka studiuar dhe punuar e kanë vënë në kontakt me njërëz, perspektiva dhe praktika nga më të ndryshmet.



## Hyrje

Ky botim sjell së bashku një përzgjedhje të kontributeve nga Seminaret e Trashëgimisë Rajonale të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Gjirokastër, Shqipëri, në shtator 2012 dhe Prizren, Kosovë, në tetor 2013.

Seminaret u organizuan si pjesë e projektit rajonal “Ballkani Perëndimor - Nga integrimi historik te pjesëmarrja aktive bashkëkohore” të vëna në zbatim nga CHwB-ja, në partneritet me Co-Plan (Shqipëri) dhe Fondacionin Mozaik (Bosnje-Hercegovinë). Ky projekt është financuar nga Komisioni Evropian me numrin e kontratës 2011/277-768. Objektivi kryesor është përdorimi i trashëgimisë kulturore si platformë për profesionistët, meshkuj e femra, për të përmbushur dhe krijuar kushtet për ripajtim si një parakusht për paqe dhe demokraci, në respekt të të drejtave të njeriut, si dhe për të nxitur rritjen ekonomike vendase përmes zhvillimit të trashëgimisë kulturore drejt një veprimtarie që gjeneron të ardhura.

Seminaret janë mbajtur në Gjirokastër dhe Prizren, qytete që ia kanë dalë mbanë të ruajnë në kohë vlerat e mëdha të trashëgimisë dhe shumëllojshmërinë kulturore. Pavarësisht bukurisë së padiskutueshme të tyre dhe statusit si destinacione turistike në rajon, të dyja qytete sot përballen me shumë sfida që lindin nga ndryshimet

sociale dhe politike, lënia pas dore, nënshtrimi i vlerave të trashëguara ndaj “kërkesave të zhvillimit” dhe nevojave të jetës së përditshme. Pamjet në këtë botim u referohen këtyre sfidave dhe synojnë t’i pasqyrojnë të dyja qytetet ashtu siç e paraqesin ato veten, qoftë kjo nga një perspektivë e zakonit apo e pazakontë.

Seminaret patën frymë krijuese, pozitive dhe frymëzuese që ndihmuan në eksplorimin e lidhjeve mes njerëzve dhe trashëgimisë. Megjithëse kjo lidhje mund të duket e qartë, për fat të keq është bërë e zakonshme që organizatat apo individët që punojnë me trashëgiminë nuk i afrojnë banorët vendas me punën që bëjnë - as përmes komunikimit bazë dhe dhënies së informacioneve. Arkeologët gërmojnë, konservuesit mbrojnë, arkitektët ndërtojnë, muzetë ruajnë dhe shfaqin... por shpesh këto veprimtari kryhen në mënyra që i përjashtojnë njerëzit të cilëve u preket trashëgimia.

Nevoja për t’u marrë me njerëzit nga ana emocionale, praktike dhe intelektuale përshkoi diskutimet dhe temat kryesore të këtyre dy seminareve. Dhe kështu, duam t’u propozojmë lexuesve strukturën e mëposhtme për këtë botim: trashëgimia dhe kujtimet, trashëgimia dhe komuniteti, trashëgimia dhe përjasjet frymëzuese.

Në fund të fundit, veprimtaritë që kanë të bëjnë me trashëgiminë kanë potencialin të lidhen me njerëzit, të lidhin njerëzit mes tyre dhe të pasurojnë jetën. Kjo mund të ketë ndikim të madh mbi zhvillimin e shoqërisë, mund të krijojë pamje pozitive, mund të zgjerojë kuptimin, mund të krijojë hapësirë për dialog dhe mund të forcojë demokracinë dhe të drejtat e njeriut... siç mund të sjellë edhe të kundërtat e këtyre gjërave.

Por mund të ndikojë edhe mbi aftësitë dhe njohuritë. Profesionisti i sotëm i trashëgimisë është dhe duhet të jetë i aftë në shumë fusha. Përveçse duhet të ketë njohuritë si specialist, i duhet të kuptojë edhe fusha të tjera si administrimi i projekteve, komunikimi, planifikimi strategjik, komunikimi dixhital, praktika krijuese, financimi, ngritja e administrimit, e kështu me radhë. Puna e izoluar është bërë përherë e më tepër e padëshiruar sepse burimet janë pakësuar dhe trashëgimia po lufton të zërë vendin që i takon - ndërkohë që kjo mund të kapet si një mundësi për zhvillimin krijues profesional dhe përmirësimin e aftësive. Trashëgimia është një forcë krijuese shpërthyesë në arenën ndërkombëtare dhe gjendet në ballë të shumë zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore.

Të dy seminarët mblodhën bashkë ekspertë ndërkombëtarë dhe rajonalë, projekte dhe individë nga një mori fushash. U gjet terreni i përbashkët në mënyrë që historitë dhe emocionet të na bashkonin të gjithëve - në kohë dhe hapësirë.

Ka shumë histori për t’u treguar dhe në shumë mënyra të ndryshme. Përmbledhjet në këtë botim janë disa prej tyre. Shpresojmë ta shijoni, t’ju duket i dobishëm dhe të bëni përpjekje për të marrë pjesë në seminarin e radhës për trashëgiminë kulturore në Jajce, Bosnje-Hercegovinë, në vjeshtën e 2014-ës.

**Vende dhe kujtime**



## Arkeologjia dhe roli i saj në një botë në ndryshim

Nga Lorenc Bejko | Prizren

Arkeologjia po mundohet të përmirësojë rolin e saj social në shoqërinë bashkëkohore. Kjo duket gjëja më e rëndësishme për suksesin e vërtetë të kësaj disipline.

Praktikuesit e arkeologjisë sot janë më të bindur se kurrë se gjithçka bëjnë ka lidhje me komunitetin si një i tërë dhe është e rëndësishme për publikun. E thënë thjesht, ne nuk mund ta përjashtojmë më veten nga të qenurit të përgjegjshëm ndaj publikut dhe t'i shërbejmë atij me të dhëna, informacion, analiza dhe rezultate të punës sonë. Ata që financojnë më së shumti punën tonë duhet ta dinë se si dhe përse bëhet apo duhet të vazhdojë kjo përpjekje.

Nga ana tjetër, të gjitha debatet teorike në arkeologji janë ndikuar fuqishëm nga vendi i ri që përpiqet të zërë arkeologjia në shoqërinë bashkëkohore. Disiplina po bëhet përherë e më tepër e përgjegjshme nga ana shoqërore për shumë arsye:

- Sjell të ardhura;
- Forcon identitete të ndryshme

- Po bëhet përherë e më aktive në formimin e ekonomive lokale;
- Po shndërrohet në një mjet efikas për edukimin dhe përmirësimin e shoqërisë.

Mbajendemend me tepërdashuri fjalët e njërit prej themeluesve të arkeologjisë shqiptare, profesor Selim Islami, pak javë para se të ndahej nga jeta, ndërsa më jepte disa këshilla mbi të ardhmen e disiplinës në vendin tonë. Një nga pikat që theksoi ishte një reflektim mbi marrëdhënien mes shkencëtarëve të vërtetë dhe publikut të zakonshëm. Shkencëtari i vërtetë, tha, nuk shkruan duke pasur në mendje publikun e zakonshëm. Shkenca e vërtetë nuk i bën dot ballë nivelit të ulët intelektual të publikut. Prandaj flet me gjuhën që e kuptojnë vetëm profesionistët. Në fillim nuk e kuptova mirë ç'donte të thoshte, por m'u duk e mrekullueshme, si një model autentik i shkencës së zhvilluar në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Ky model i të menduarit intelektual duket se ishte një produkt i drejtpërdrejtë i një kohe të ndryshme nga e jona. Ishte e lidhur ngushtë me emergjencën e zhvillimit të shteteve me axhenda identitetesh dhe krenarish kombëtare. Prandaj ishte e rëndë-

sishme për arkeologjinë e asaj kohe. Megjithatë, që arkeologjia të jetë po aq e lidhur edhe me shoqërinë e sotme, ajo duhet të përqendrohet në një numër temash të ndryshme, që janë qendrore në diskutimin për shoqëritë tona sot. Temat për arkeologjinë si shkencë aktive sociale sot duhet të përfshijnë, por jo vetëm:

- Pabarazitë dhe padrejtësitë shoqërore. Arkeologjitë e pabarazisë; sigurisht që kjo është sot një çështje kyçe për shoqërinë njerëzore. Arkeologjia mund ta eksplorojë këtë temë për nga origjina dhe roli që ka luajtur në nevojat e qytetërimeve të para. Pabarazitë shoqërore mund të eksploroohen edhe në të ashtuquajturat “shoqëri barazimtare” të gjahtarëve, por ajo që do të ishte e rëndësishme është shpjegimi i shembujve të shumtë të rolit parësor që ka pasur pabarazia shoqërore në përmbysjen e rendeve shoqërore apo shpërbërjen e shoqërive të vogla. Komunitetet parahistorike kanë vënë shpesh në zbatim strategji si bashkëpunimi social dhe qasja e barabartë ndaj burimeve dhe përfitimeve në përgjigje të rreziqeve nga konfliktet shoqërore dhe rrënimi i sistemit.

- Ndryshimet klimatike në të shkuarën dhe mënyrat për t'u përballur me sukses me to; ky është një tjetër tipar që ka shoqëruar ecurinë e shoqërive të hershme njerëzore. Zhvillimi i arkeologjisë mjedisore ka qenë shumë i rëndësishëm në ofrimin e një morie të dhënash për paleomjediset. Megjithatë, është thelbësore për arkeologjinë të eksplorojë dhe informojë se si ndryshimi i klimës ka ofruar edhe mundësi të reja për njerëzit, që ata të ripërshtateshin me kushtet e reja, të rimendonin marrëdhënien e tyre me burimet natyrore apo të riformonin ekonominë e tyre.
- Degradimi mjedisor dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Historia është plot me raste ku degradimi i mjedisit nga veprimtaritë njerëzore ka qenë shkaku kryesor për rënien e qyteteve dhe qytetërimeve. Arkeologjia i ka në dorë mjetet për të ilustruar këto procese dhe për të informuar diskutimet e sotme mbi çështje të ngjashme.
- Mungesat e ushqimit. Roli i bujqësisë, blegtorisë dhe prodhimit të ushqimit në zhvillimin shoqëror. Arkeologjia mund të shqyrtojë raste të ndryshme në të shkuarën kur uria dhe prodhimi i ushqimit kanë qenë forcat kryesore shtytëse në zhvillimin shoqëror. Ato kanë qenë shkaqe

konfliktesh dhe risish për efikasitet ekonomik dhe bashkëpunim shoqëror përmes shtrirjes së rrjeteve të tregtisë. Modelet e ngujimeve kanë ndryshuar duke pasqyruar specializimin në prodhimin e ushqimit, si bujqësia kundrejt blegtorisë, tregtisë e grumbullimit.

- Mungesa e ujit, ndotja e ujit dhe strategjitë e zhvilluara nga shoqëritë e shkuara në kohë thatësirash. Rizbulimi i strategjive të vjetra për të administruar me efikasitet burimet ujore, mund të jetë tepër i dobishëm për diskutimin e sotëm mbi dezertifikimin e lidhur me ndryshimet klimatike. Nga ana tjetër, sistemet e administrimit të ujit, prej kohësh janë mbajtur si përgjegjës për rritjen e ndërlkimeve shoqërore në disa nga qytetërimet e hershme.
- Natyra e qytetërimeve të hershme dhe shkaqet e rrënim-it të tyre. Shqetësimet tona bashkëkohore për zhvillimin e paqëndrueshëm në metropolet dhe qendrat urbane mund të krahasohet me qytetërimin e një “shkalle njerëzore” gjatë shumicës së të shkuarës. Qytetet tona të mbipopulluara i kanë humbur shumë nga funksionet e tyre shoqërore dhe kanë lënë pas dore shumë nga elementët që përbëjnë “cilësinë e jetës” së njerëzimit.
- Origjinat e konfliktit dhe luftës, sidomos të konfliktit shoqëror në shoqëritë e shkuara. Arkeologjia ndodhet në

pozicion të mirë për të informuar shoqërinë e sotme mbi rëndësinë e konfliktit dhe luftës në të shkuarën. Shfaqja e “shteteve ushtarake” dhe “forcave paraushtarake të paorganizuara” janë mjaft të rëndësishme për zhvillimet e sotme, veçanërisht për përhapjen e kërcënimeve terroriste anembanë botës.

- Roli i punës në zhvillimin shoqëror. Nga format e punës shoqërore te skllavëria, nga puna e fëmijëve në të shkuarën te rizbulimi i shumë zejeve dhe traditave të punës në ekonominë bashkëkohore.
- Gjinia dhe roli i saj në formimin e historisë njerëzore. Etniciteti dhe globalizimi. Asnjë disiplinë tjetër nuk e shfaq veçantinë kulturore të një forme shoqërie ashtu si “gjinia”. Roli i rëndësishëm i grave në histori gjen shprehje të pafundme në kontekstet arkeologjike. Arkeologët duhet t’i shohin me më tepër kujdes dhe të ndihmojnë në kuptimin e rolit të gjinisë në shoqëritë tona. Shprehjet kulturore të identiteteve etnike dhe shembujt shumë të hershëm të lidhjeve në largësi të mëdha mes bashkësive njerëzore ofrojnë një perspektivë të veçantë të etnicitetit dhe globalizimit, të cilat kanë bashkeqzistuar prej një kohe shumë të gjatë dhe sigurisht, mund të vazhdojnë kështu në “fshatin global” të së sotmes.



- Arkeologjia dhe kushtet njerëzore. Trajton çështje ekzistenciale të të qenit njeri, vetëdijen, kuptimin për vetveten, ankthin, vuajtjen, qëndrimin ndaj vdekjes, moralin, emocionin, dashurinë, estetikën, artin, frikën, shpresën e shumë të tjera. Arkeologjia mund t’i përvijojë këto tipare të njeriut në perspektivë afatgjatë, të studiojë zhvillimin e tyre kontekstual dhe historik dhe të sigurohet që ato janë qendrore për natyrën e species sonë në të ardhmen.
- Ruajtja e trashëgimisë arkeologjike si një burim i parinovueshëm në shërbim të një shoqërie më të mirë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive është veçanërisht e rëndësishme në shoqërinë tonë. Ajo ka fuqinë të krijojë një lidhje fizike me të shkuarën dhe nxit një përjasje reflektive me të tashmen dhe të ardhmen. Tri rastet studimore të diskutuara (tumat mortore në Kamenicë, Lofkënd dhe Shtoj në Shqipëri) tregojnë tri mënyra të ndryshme ku tipare të njëjta arkeologjike siç janë tumat mortore prehistorike, lidhin dhe ndërveprojnë me bashkësitë e sotme. Roli i arkeologëve dhe i specialistëve të trashëgimisë është thelbësor në shndërrimin e këtyre monumenteve të trashëgimisë nga tipare pasive peizazhi në kontribuues aktiv në ngritjen e identitetit lokal, jetës kulturore, mundësisë ekonomike apo rolit edukativ mes shumë të tjerash.



## Amfiteatri romak i Durrësit, një vend arkeologjik me të ardhme potenciale turistike të pashfrytëzuar

Nga Armada Molla | Prizren

Amfiteatri romak i Durrësit është një nga amfiteatrot më të mëdha të Ballkanit që mishëron vlera të veçanta arkitekturore dhe kulturore. I vendosur në qendër të qytetit të Durrësit, ende i pazbuluar plotësisht dhe sigurisht në një gjendje të tmerrshme ruajtjeje dhe restaurimi, ky monument, embleme e qytetërimit mijërvjeçar dhe kujtesë e vërtetë informative historike për brezat është renditur si një nga 7 monumentet dhe vendet më të rrezikuara në Evropë nga një program i nisur prej Europa Nostra, zëri i Trashëgimisë Kulturore Evropiane, në janar 2013.



Mundësuar nga ADCT

Qyteti i lashtë i banuar nga fisi ilir i Taulantëve u themelua nga mbreti Epidamn në shekullin e 7-të p.e.s dhe ishte një nga qytetet e para të ngritura buzë Detit Adriatik. Gjatë kolonizimit grek, qyteti i njohur me emrin Dyrrhachion shtrihej në një sipërfaqe prej 100 ha, duke u bërë kështu një qendër

e famshme arti e kulture<sup>1</sup>. Gjatë periudhës romake, Dyrrachium ishte port i madh i Ilirisë dhe pikënisja e rrugës Egnatia, rruga lidhëse mes Romës e Kostandinopojës. I përmendur për herë të parë nga humanisti shqiptar Marin Barleti gjatë shekullit të 16-të<sup>2</sup>, ky monument i rëndësishëm që daton pas në shekullin e 2-të p.e.s. ka qenë gjithnjë një pikë studimesh për profesionistët. Shumë arkeologë dhe studiues si Evans, Heuzey, Daumet, Praschniker, Schober, Rey etj. e kanë vizituar qytetin por Vangjel Toci (1920-1999), një arkeolog shqiptar, ishte i pari që pati sukses me gërmimet dhe nxori në dritë një pjesë të amfiteatrit<sup>3</sup>. Ndërtimi i tij pjesërisht në kodër e pjesërisht në fushë duhet të ketë pasur 15.000-20.000 vende.

Amfiteatri ka boshte eliptike të orientuara veri-jug dhe lindje-perëndim, çka lidhet në mënyrë të përsosur me planifikimin e qytetit. Gjatësia e boshteve është: 126 m x 106 m dhe arena 61 m x 62 m<sup>4</sup>.

Trashëgimia kulturore e Durrësit (amfiteatri, forumi i rrumbul-

- 1 A. Hoti Epidamons-Dyrrhachion Durrës, Tiranë 2006, fq.18
- 2 M. Barleti - Historia e Gjergj Kastriotit, i mbiquajtur Skënderbej, Mbreti i Shqipërisë, përkth. Z. I. Gentlemen, Londër 1596, fq.488
- 3 V.Toci, Amfiteatri i Dyrrahut, Monumentet 1971, fq.40-42
- 4 Miraj, L. Amfiteatri i Durrësit, Iliria, (1986/2) 151-171.

lakët bizantin, muret romake, bizantine dhe osmane, kulla veneciane, etj.) luan një rol thelbësor në zhvillimin e turizmit. Si një nga pikat më tërheqëse turistike, amfiteatri është një vend i mrekullueshëm për t'u vizituar dhe lehtësisht i arritshëm nga të gjitha kategoritë e vizitorëve, ndërkohë që një e treta e tij është e dukshme.

Për shkak të zbulimit të vonë, monumenti u cenua nga planifikimi kaotik urban i cili e preku strukturën e tij ndërkohë që

vuan nga lënia pas dore. Me propozim të Shoqatës për Zhvillimin e Turizmit Kulturor (SHZHTK) në Shqipëri, amfiteatri romak i Durrësit është renditur si një nga 7 monumentet më të rrezikuara të Evropës, një veprim ky që synon jo vetëm shpëtimin e monumentit por edhe përmirësimin e tij, si rrjedhojë, rigjallërimin e gjithë zonës arkeologjike dhe historike, duke krijuar më tepër mundësi për zhvillimin e turizmit kulturor dhe duke nxjerrë në pah qytetin si një destinacion potencial turistik.



Mundësuar nga ADCT

## **Hidrocentrali Prizrenasja: një vështrim i shkurtër mbi historikun e ndërtimit**

*Nga Nora Arapi Krasniqi | Prizren*

Historia e hidrocentralit prizrenasja është e lidhur ngushtë me historinë e elektrifikimit në Kosovë. Në Kosovë, energjia elektrike nisi të prodhohej në fillim të shekullit të 20-të, kur në Ferizaj u vendos në vitin 1922 gjeneratori i parë i cili i jepte energji mullirit gjatë ditës dhe ofronte energji për afro 60 shtëpi gjatë natës.

Hidrocentrali Prizrenasja ndodhet në pjesën lindore të Prizrenit dhe paraqet një nga hidrocentralet e para të ndërtuara në Kosovë. U ndërtua në vitin 1929 sipas një projekti të skicuar nga një zyrë austriake dhe i dha energji Prizrenit për 44 vjet me radhë. Me mbërritjen në qytet të energjisë elektrike, jeta kulturore dhe ekonomike u gjallërua. Në vitin 1929 u hap kinemaja e parë, u zhvilluan zeje të reja si: prodhimi i prizave prej druri, zileve të dyerve dhe transformatorëve të vegjël. Hidrocentrali furnizonte me energji institucionet publike, banesat e njerëzve të pasur, mullinjtë dhe institucionet tregtare. Për shkak të mungesës së kapacitetit dhe pajisjeve të vjetruara, hidrocentrali pushoi së funksionuari në vitin 1973.



Mundësuar nga Nora Arapi Krasniqi



ato të lidhura me vlerat shpirtërore por edhe ato industriale. Që nga viti 1981 kur pushoi së funksionuari falë mungesës së mirëmbajtjes dhe lënies pas dore, ka nisur edhe degradimi i tij.

Hidrocentrali Prizrenasja përfaqëson një ndërtesë të rëndësishme në historinë e zhvillimit të energjisë elektrike në Kosovë.



Mundësuar nga Nora Arapi Krasniqi

Si e tillë, ka vlera të mëdha historike, artistike, sociale, shkencore dhe mjedisore.

Vlerat historike - Këto vlera historike të ndërtesës lidhen me ekzistencën e makinerive origjinale për prodhimin e energjisë dhe ruajtjen e pjesëve funksionale që tregojnë mënyrën e funksionimit të hidrocentralit.

Vlerat artistike - Është një nga ndërtesat e para industriale me trajtim të veçantë arkitekturor, që përfaqëson nisjen e arkitekturës moderne dhe ndikimin evropian në arkitekturën e Prizrenit. Vendndodhja, forma, përzgjedhja e materialeve të ndërtimit krijojnë vlerat artistike të kësaj ndërtese.



Mundësuar nga Nora Arapi Krasniqi

Vlerat sociale - Hidrocentrali përfaqëson simbolin e shndërrimit të shoqërisë së Prizrenit nga jeta primitive në jetën moderne.

Vlerat shkencore - Vetëm ndërtesa përbën një provë të shkëlqyer të prodhimit të energjisë elektrike duke përdorur fuqinë e ujit në fillim të shekullit të 20-të.



Mundësuar nga Nora Arapi Krasniqi

Vlerat mjedisore - Vendi ku ndodhet ndërtesa ka vlera të larta mjedisore pasi gryka e Lumbardhit me malet e Sharrit krijojnë një harmoni të plotë mes arkitekturës, teknologjisë dhe natyrës.

Në vitin 2012, me financim të ambasadës së SHBA-së në Kosovë, u hartua Projekti Restaurues i Hidrocentralit. Projekti u skicua dhe zbatua nga zyra e CHwB-së në Kosovë në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren. Nëntori 2013 shënon përfundimin e punëve restauruese në ndërtesë.

Sfida e tanishme ka të bëjë me rivënien në funksionim të Muzeut të historisë energjetike - krijimi i një modeli kombëtar për integrimin e standardeve ndërkombëtare për muzetë në procesin e restaurimit të një ndërtesë industriale dhe ngritja e kapaciteteve përmes një bashkëpunimi shumë-disiplinar.

Risjellja në jetë e kësaj ndërtese, duke e shndërruar atë në një institucion edukativ-kulturor, do të paraqiste historinë e elektrifikimit të Prizrenit dhe, njëherësh, do të lejonte integrimin e kësaj ndërtese në ngjarjet kulturore të qytetit.

Një vend trashëgimie që pret të rifutet në jetën e njerëzve.



Mundësuar nga Nora Arapi Krasniqi

## Ripërdorimi i mjediseve të dikurshme industriale: disa vëzhgime nga pikëpamja e konservimit

Nga Bosse Lagerqvist | Prizren

Procesi i industrializimit në botën perëndimore në përgjithësi përshkruhet si një zhvillim përmes tri pikave kryesore të ndryshimit; zëvendësimi i pajisjeve të mëparshme që punonin me fuqinë e ujit me fuqinë e avullit gjatë shekujve të XVI-të dhe XVII-të, futja e linjave të montimit së bashku me zëvendësimin e fuqisë së avullit me elektricitetin gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të 20-të dhe së fundi, automatizimi i procedurave të punës dhe vendosja e shërbimeve të prodhimit në vendet me të ardhura të ulëta (Isacson & Morell, 2002; Isacson, 2007). Zhvillimi i fundit, një proces që pak a shumë po vazhdon ende, nisi në vitet 1960-të dhe 1970-të dhe rezultoi me braktisjen e komplekseve industriale në periudhën mes viteve 1970 dhe 1990. Ky zhvillim u hapi udhë proceseve që, së bashku me veprimtaritë e mëparshme industriale historike në Suedi, përgatitën terrenin për futjen e mbetjeve industriale si trashëgimi. Pjesë domethënëse në këtë zhvillim në Suedi ishin mbylljet e uzinave të prodhimit të hekurit dhe metaleve në gjysmën e dytë të shekullit të XIX-të, çka rezultoi me disa raste vendesh të mbrojtura *de facto*: në 1923-24, Muzeu Kombëtar i Teknologjisë u vendos në Stokholm pas ekspozitës së panairit botëror në Gothenburg, ku industria moderne suedeze u paraqiti si e ngritur mbi his-

torinë industriale kombëtare ndërsa në vitet 1930 Muzeu Nordik mbledhi histori dhe kujtime nga jeta e punës të cilat, më vonë, në vitet 1940 dhe 1950, u organizuan në degë specifike (Industriminnen, 1979; Isacson, 2003). Në 1966, u formua Grupi Historik Metalurgjik nga Shoqata Suedeze e Prodhuesve të Çelikut, e ashtuquajtura “Zyra e hekurit” që ishte krijuar qysh në shekullin e XVII-të. Objektivi ishte mbështetja e kërkimeve në këtë fushë dhe sigurimi i shpërndarjes së rezultateve të përqëndruara mbi studimet arkeologjike dhe historike mbi prodhimin e metaleve dhe hekurit (webfaqja e Jernkontoret). Kështu pra ishte ngritur një themel i përgjithshëm i ndërgjegjesimit historik industrial kur numri i mjediseve të mbyllura industriale u rrit ndjeshëm në vitet 1970-të.

Tri tipare u bënë domethënëse për zhvillimin në Suedi të praktikës së trashëgimisë industriale. Së pari, punët restauruese të financuara nga qeveria, të veprave industriale, gjatë viteve 1970 me objektiv uljen e papunësisë në sektorin e ndërtimit. Së dyti, e ashtuquajtura lëvizja e gjermimeve që nxiti qarqet studiuëse, të përbëra nga punëtorët industrialë, të studionin historinë e tyre. Së fundi, industrinë më të braktisura gjëndeshin jashtë

zonave urbane dhe mbyllja e industrive shpesh kishte pasoja të rënda për bashkësitë lokale. Potenciali që vlerat e trashëgimisë të ktheheshin në kapacitete instrumentale për të krijuar mundësi të reja punësimi u bënë përherë e më tërheqëse gjatë viteve 1980-të për bashkësitë e përfshira në to. Me financimin e qeverisë për të ulur papunësinë dhe për të financuar mbështetjen për punët restauruese, u siguruan burimet për të lehtësuar problemet në rritje në fushën e trashëgimisë së lidhur me vendet industriale.

Gjatë po kësaj faze, lëvizja e gjermimeve ofroi të dhëna kontekstuale të bazuara lokalisht për forcat shtytëse që qëndronin pas zhvillimit industrial lokal, normalisht të integruara me historinë e bashkësive lokale. Shpesh, qarqet studimore u zhvilluan në muze të punës mbështetur në nevojën e punëtorëve të mëparshëm për të dokumentuar dhe ruajtur njohuritë teknologjike të lidhura me një vend apo proces të caktuar. Këto muze urritën shpejt në numër dhe sot numërohen mes 1400 dhe 1500 muze (webfaqja “The Working Life Museums”).

Dy raste studimore për Forsik Works dhe Fengersfors Works shërbejnë si shembuj për këto procese shndërruese gjatë 30 viteve të fundit.

Për Forsvik Works, mjedisi industrial përfaqëson një interpretim studimor-historik të historisë industriale që ofron mundësi për njohuri dhe vlerat e trashëgimisë janë përcaktuar pasi: a) të gjitha ndërtesat dhe strukturat konsiderohen shtresa historike autentike, b) nismat për ripërdorim mbështeten në interpretimet historike, c) aftësitë industriale janë një element i rëndësishëm jomaterial i trashëgimisë industriale dhe duhen mësuar, transmetuar e zhvilluar dhe d) financimi publik është një investim i domosdoshëm me përfitime sociale neto (Bergström 2002). Në Fengersfors Works, mjedisi industrial përfaqëson një vend dinamik për një numër veprimtarish zhvilluese dhe përmbytja e trashëgimisë është përkufizuar si: a) një vend pune për grupetë ndryshme profesionale, b) një vend prodhimi që është ndryshuar vazhdimisht duke ndjekur ndryshimet e shoqërisë për-reth, c) një vend që kontribuon për ekonominë lokale dhe d) veprimtari që i mbulojnë vetë kostot e tyre (Langerqvist, 2007).

Këto dy vende paraqesin dallime në atë se si është interpretuar domethënia historike dhe, rrjedhimisht, si janë formuluar strategjitë e ripërdorimit. Njëherësh këto raste tregojnë ngjashmëritë se si mund t'iu qasesh mbetjeve industriale brenda kuadrit të praktikave të trashëgimisë industriale me objektiv integrimin e interpretimit të domethënies historike me interesat e paleve të përfshira, për të krijuar baza të qëndrueshme për mundësitë e ripërdorimit. Autori mbështet praktika trashëgimie më elastike e dinamike që integrojnë emocionalisht, intelektualisht dhe praktikisht perspektivat të cilat trajtojnë rëndësinë e interpretimit dhe vlerësimit në përcaktimin e rezultateve restauruese dhe transformuese të synuara. Produkti i trashëgimisë brenda fushave të historisë së industrisë dhe teknikës duhet kuptuar si një proces dinamik i cili mund të përfitojë nga një integrim më i mirë mes njohurive përkatëse dhe veprimtarive të përjetuara emocionalisht. Ky integrim ka të bëjë edhe me mundësitë për të përmirësuar lidhjet bashkëpunuese mes industrisë prodhuese bashkëkohore dhe vendeve të trashëgimisë industriale, lidhje që kanë të bëjnë me dijet e pashprehura ("*tacit knowledge*"), sipërmarrjet inovative që lindin nga traditat industriale dhe zejtare dhe mundësitë për të ringjallur ekonominë lokale.

## Referenca

- Bergstrom, Lars (2002) "Forsviks's Bruk: A Tragic Industrial Closure or an Industrial Historical Success?" In: The Construction of Built Heritage. Ed. Angela Phelps, Gregory J. Ashworth, Bengt O.H. Johansson. Aldershot, UK: Ashgate
- Industriminnen. En bok om industrioch teknikhistoriska bebyggelsemiljöer (1979). Red. Marie Nisser. Stockholm: Sveriges arkitekturmuseum
- Isacson, Maths. (2003) "Industrisamhällets faser och industriminnesforskningens uppgifter". In: Industrins avtryck. Perspektiv på ett forskningsfalt. Red. Dag Avango & Brita Lundstrom. Stockholm/Stehag: Brutus Ostlings Bokforlag Symposium
- Isacson, Maths. (2007) Industrisamhället Sverige. Arbete, ideal och kulturarv. Lund: Studentlitteratur.
- Isacson, Maths & Mats Morell. (Red.) (2002) Industrialismens tid. Ekonomisk-historiska perspektiv på svensk industriell omvandling under 200 ar. Stockholm: SNS Forlag
- Jernkontoret. History of metallurgy. The Swedish Steel Producers' Association; The Historical Metallurgy Group [http://www.jernkontoret.se/english/research/history\\_of\\_metallurgy/index.php](http://www.jernkontoret.se/english/research/history_of_metallurgy/index.php) (10 July 2013)
- Lagerqvist, Bosse (2007) "Fengersfors Works - musealisation to working order as instrument for regional development". Paper presented at: Big Stuff '07. Beyond conservation - Industrial heritage management. Bochum and Hattingen, September 11 -14 2007
- The Working Life Museums Co-operation Council. A national association of enthusiasts <http://www.arbetsam.com/english/english.htm> (July 11, 2013)





## Historitë janë bërë për t'u treguar

Nga David Perrin | Prizren

Trashëgimia ka të bëjë me tregimin e historive. Historitë kanë të bëjnë me atë se si komunikojmë me njerëzit, si lidhemi me të shkuarën, me familjet, komunitetin tonë; kanë të bëjnë me atë çfarë marrim me vete në të ardhmen si identitetin tonë, si një monedhë me të cilën blejmë një farë kuptimi të përkatësisë.

Si njerëz që jemi, historitë tona mund të jenë të prekshme ose të paprekshme. Tradicionalisht, sektori i trashëgimisë funksionon brenda kufijve të së prekshmes, duke shfaqur sende nëpër kuti të qelqta me etiketa që tregojnë përdorimin, datën dhe vendin e zbulimit. Historitë, si rregull, janë objektive kur nuk përmbajnë asnjë vlerë të shtuar, asnjë emocion shtesë. Kur janë ashtu si janë.

Pyetja që duhet të bëjmë si profesionistë të trashëgimisë ndoshta është si mund të thuhet ndryshe historitë që të ngjallin e nxisin emocione mes dëgjuesve. Kjo është një çështje tepër e ndjeshme dhe ndoshta nuk ka përgjigje, sidomos në një kohë kur vullneti politik dhe klima ekonomike janë, me sa duket, kundër kësaj. Besoj se kërkon një rikonceptim të madh ideja se çfarë është muzeu, duke u larguar nga koncepti i katër

mureve me një çati, sidomos në një rajon ku konfliktet janë pjesë të historisë së afërt dhe ku historitë ende nuk kanë ardhur në një format të prekshëm. Rugët e një qyteti, njerëzit janë vetë muzeu. Historitë e tyre janë ato që duhet të kërkojnë muzetë për t'i regjistruar dhe ruajtur për brezat e ardhshëm.



Një mënyrë e thjeshtë por efikase për ta bërë këtë në epokën numerike është ajo përmes fotografisë. Kjo fotografi, për shembull, tregon një zotëri të moshuar në Prizren, Kosovë. Fytyrën ia mbuloi një buzëqeshje kur pa që i kisha drejtuar aparatën.

Pasi e fotografova, iu ula pranë dhe, me ndihmën e një miku që shërbente si përkthyes, e falënderova dhe kalova disa minuta me të. Shkëmbeu disa fjalë me mikun tim dhe nisi të tregonte historinë e tij. Kishte lindur në Prizren, Kosovë, ishte rritur mes pakicës turke dhe punonte si këpucar. Fliste vetëm turqisht. Historia e tij ofronte një perspektivë interesante të historisë së Prizrenit dhe më lejoi të kërkoja dhe zbuloja ndikimin e Turqisë në një qytet që e kisha menduar se ishte ndikuar më së shumti nga Shqipëria dhe, ndoshta, Serbia.

Fotografia në krah tregon ndërtesat e minierës së Trepçës, në rrethinat e Mitrovicës. Ndërtesat janë të braktisura e të lëna pas dore, një pasqyrim i trishtuar i jetës së sotme në Mitrovicë ku papunësia është gati 70% mes popullatës nën 25 vjeçare dhe ku të ardhurat e disponueshme mesatare ditore janë 1.5 Euro. Ato tregojnë po ashtu historinë e një qyteti që dikur ishte lokomotiva industriale e rajonit, ku nxjerrja e burimeve natyrore punësonte 20,000 njerëz.

Historitë janë bërë për t'u treguar. Disa nuk janë të këndshme apo për t'u krenuar dhe shumë prej nesh do t'i harrojnë shpejt e do të bëjnë përpara. Po nuk duhet të harrojmë, sepse historitë janë ato që na kanë bërë ata që jemi sot, ato na kanë dhënë identitetin dhe na lidhin me historinë tonë, me kulturën dhe popullin tonë. Është puna e sektorit të trashëgimisë t'i ruajë dhe të sigurohet që ato të tregohen.



## Trashëgimia dhe bashkësitë



## Diskutim paneli - si i lidh trashëgimia njerëzit?

Nga Diana Walters | Prizren

Mëngjesi përmbyllës i seminarit i mbledhi së bashku të gjitha linjat e diskutimit me kontribuesit kryesorë. Qëllimi i kësaj seance ishte të arrihej një pasqyrim real i natyrës shumëfaqëshe të trashëgimisë dhe këndvështrimeve nga pikënisje të ndryshme. Ishte një lloj “koktejl trashëgimish” - dhe sigurisht nxiti komente dhe diskutime.

Folësit përfaqësuan të gjithë fusha të ndryshme të trashëgimisë, - një arkeolog, një arkitekt, një drejtor muzeu kombëtar, një fotograf, një këshilltar për trashëgiminë, një ekspert për zhvillimin e bashkësive. Secilit iu dha një fjalë specifike, vetëm tri faqe Power Point dhe dhjetë minuta kohë duke iu kërkuar të reflektojnë për kuptimin dhe rëndësinë e asaj fjale për veprimtarinë bashkëkohore në fushën e trashëgimisë.

Fjalët ishin Parà, Vend, Histori, Emocione, Ndërtesa, Identitet, Ushqim dhe Jetë pune (“*working life*”).

Interpretimet ishin të gjitha ngacmuese dhe plot mendim, dukej qartë që përdorimi i një fjale të vetme i kishte sfiduar

edhe i kishte frymëzuar njerëzit të përqendroheshin te kuptimi dhe vlerat thelbësore. Për disa, fjala kishte një rezonancë të fuqishme vetjake - një lloj kuptimi i vetes, i vendit në botë, një lloj reflektimi. Këto reflektime u shfaqën shpesh tepër të fuqishme e të thella - dhe si të tilla patën ndikim të madh në seminar. Lidhja e trashëgimisë me natyrën kalimtare të jetës së përkohshme ngjalli po ashtu një varg përgjigjesh emocionale dhe u debatua mbi hapësirën ku ajo përbën sfidë, sidomos në shoqëritë që përjetojnë ndryshime dhe tranzicione të shpejta. Diskutimi po ashtu ngriti çështjen e asaj se për çfarë shërben trashëgimia dhe pse është kaq e rëndësishme për njerëzit. Sfidat me të cilat përballet bota e trashëgimisë dhe nevoja e saj për të mbijetuar e për të qenë e bashkëlidhur ishte një nga këto linja - çfarë duhet të bëjmë për ta siguruar këtë?

Në përgjithësi, seminari tregoi lidhjen e trashëgimisë - me dhe mes njerëzve, mes historive të tyre dhe jetëve të tyre të përditshme. Kjo ishte me rëndësi.



## Trashëgimia si katalizator për zhvillimin e qëndrueshëm

Nga Daniel Laven | Gjirokastra

Çfarë thotë shkenca? Vëzhgime nga studimi në zonat amerikane të trashëgimisë kombëtare

Zonat e trashëgimisë kombëtare (ZTK) janë vende të përcaktuara nga Kongresi amerikan, ku burimet natyrore, kulturore dhe historike gërshetohen për të formuar një peizazh të njehsuar. Këto zona flasin për histori që i thurin lavde trashëgimisë së shumëllojshme të SHBA-së (Bordi Këshillimor i Sistemit të Parqeve Kombëtare 2006). ZTK-të ndryshojnë shumë për nga madhësia, dinamikat e bashkësive vendore dhe burimeve të trashëgimisë, si dhe nga përvojat e kapacitetet për administrimin e burimeve. Pavarësisht ndryshimeve, ZTK-të kanë të përbashkët qëllimin për të integruar synimet e ruajtjes së burimeve (natyrore, kulturore) me objektivat e zhvillimit të ekonomisë dhe të bashkësive nëpër pika të shumta brenda një peizazhi të përcaktuar apo një rajoni (Bordi Këshillimor i Sistemit të Parqeve Kombëtare 2006).

Mes viteve 2004 dhe 2009, raste studimesh janë kryer në disa ZTK (Copping et al. 2006, Jewiss et al. 2008; Laven 2006; Laven et al. 2012; Laven et al. 2010a; Laven et al. 2010b; Tuxill et al. 2008; Tuxill et al. 2005). Një përfundim i rëndësishëm nga ky

studim është roli i qartë i trashëgimisë në nxitjen e veprimeve të menaxhimit të kujdesshëm, sidomos në bashkësitë me histori të vështira. Ka shembuj të shumtë në të dhënat e studimit ku të intervistuarit përshkruajnë fuqizimin që sjell shfrytëzimi, artikulimi dhe kuptimi i trashëgimisë së rajonit të tyre. Katër shembujt që vijojnë, të nxjerra nga të dhënat e studimit, ilustronë fuqinë e trashëgimisë së përbashkët për të frymëzuar veprime kolektive:

Kështu pra, mendoj se historia [e bashkësisë sonë] është historia e shndërrimit nga një shoqëri agrare në përpunuese. Si të gjitha qytetet e vjetra të manufakturës në verilindje [të SHBA-së], kaloi një periudhë rënieje me një lloj trashëgimie negative. Por ekziston mundësia për ta shndërruar këtë perspektivë duke folur për ndryshimet pozitive që ndodhën dhe për mundësitë për t'u përmirësuar krahasuar me të shkuarën, si dhe për të ndrequr një pjesë të asaj që u prish gjatë atij procesi. Sjell ndërmend këtu Lumin Bllekston dhe mundësitë për të kryer disa rregullime mjedisore përgjatë tij. Ja pse e pëlqejnë njerëzit këtë

histori, sepse shohin mundësinë dhe e kuptojnë përherë e më mirë që trashëgimia e tyre mund të shërbejë si gur themeli për përparimin në të ardhmen (Laven 2006, fq. 43-44).

Mendoj se ZTK-ja ka një ndikim të madh sepse ka ndihmuar bizneset dhe organizatat që duan të përmirësojnë infrastrukturën e bashkësisë. Duke vënë bashkë njerëz nga organizata të ndryshme me qëllime të ndryshme, [ajo e kthen] bashkësinë në një vend ku [njerëzit] ndjehen krenarë që janë nga ai vend. Po kjo nuk ndodhte për shumë breza. [Rajoni ynë] 20 vjet më parë ishte një zonë e rrënuar dhe e varfër dhe jo shumë njerëz e thoshin me krenari që jetonin atje. Tani kjo ka ndryshuar. Jo vetëm familjet që kanë jetuar aty prej gjashtë apo shtatë brezash janë krenare, por ka edhe plot profesionistë që kërkojnë të jetojnë [aty]. Tani vendi është bërë një destinacion për bashkësinë dhe jo një zgjedhje e fundit për këtë bashkësi (Laven 2006, fq. 46). Në fakt, ne jemi rrjedhojë e Revolucionit Industrial... Ndotja që dëmtoi faqet e maleve ishte rrjedhojë e drejtpërdrejtë e

shkrirjes së zinkut. Dhe [tani] po përballemi me pasojat përsa i përket ndotjes. Por kemi punuar fort për të nxjerrë në pah të gjitha anët pozitive që kanë bërë kompanitë e zinkut për bashkësinë tonë. Kështu, po ndihmojmë që të mësohet kjo histori dhe vendi ynë në të. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për atë që po bëjmë (Laven 2006, fq. 68).

Ka të bëjë me rrëfimin e historisë. Sot, gjendja është njësoj si në fund të shekullit të kaluar. Ka valë të ndryshme grupesh emigruese që vijnë. Po a e dini çfarë? Megjithëse bëjnë punë të ndryshme, përballen me të njëjtat përvoja dhe me të njëjtat paragjykime si të ardhurit e mëparshëm. Kjo është një përvojë e zakonshme dhe na duket se, kur gërmojmë nëpër tradita të ndryshme, ka plot të përbashkëta nëse i vendos bashkë këto grupe. Mendoj se kjo shërben për të rrëzuar disa nga barrierat natyrore që ngrenë vetë njerëzit. Prandaj, tregimi i kësaj historie, por pa u përpjekur ta ëmbëlsojmë, është i rëndësishëm. Ka plot gjëra të këqija. Po e dini çfarë? Këta jemi ne dhe ja vlen ta tregojmë. Kjo ka rëndësi (Laven 2006, fq. 44).



## Trashëgimia në një kontekst më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm: Shembuj frymëzues nga mbarë bota

Modelet e vëzhguara përmes studimeve të ZTK-ve (që trashëgimia mund të jetë agjent katalizator për veprimet e zhvillimit të qëndrueshëm), duket se përputhen me një varg përpjekjesh inovative, megjithëse të ndryshme, në mbarë botën. Mbështetur në diskutimin për ZTK-në e mësipërme, kjo pjesë përshkruan shkurt tre shembuj që ilustronë ndikimin e trashëgimisë në veprimtaritë e zhvillimit të qëndrueshëm.

### Gaviotas

Gaviotas, një fshat ekologjik në zemër të savanës lindore të Kolumbisë, ka tërhequr së tepërmi vëmendjen përmes një botimi të vitit 1980 nga Alan Weisman *“Gaviotas: fshati për të rish-pikur botën”* (i ribotuar më vonë në vitin 2008 me rastin e 10 vjetorit). Që nga libri i Weismanit, Gaviotas është diskutuar në letërsinë shkencore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm për shkak të përjasjes së tij të re dhe frymëzuese në ripërcaktimin e marrëdhënieve njeri-natyrë (p.sh. Blewitt 2008; Kaihla 2007; Pearce et al. 2012).

Tregimi i Weismanit nis me përshkrimin e traumës së thellë që karakterizonte një pjesë të madhe të përvojës kolumbiane në

shekullin e 20-të. Gjatë kësaj epoke, Kolumbia përpëlitej mes një lufte civile prej disa dhjetëvjeçarësh, një tregtie të paligjshme e të dhunshme droge, çështjeve të mprehta ekonomike dhe të varfërisë dhe një mori sfidash të tjera të lidhura shpesh me emergjencën pas-koloniale<sup>1</sup>. Nisur nga ky pikëvështrim, Weismani përshkruante se si “vizionarët” e Gaviotas e përdorën traumën e përvojës kombëtare kolumbiane për të ndërtuar një alternativë thellësisht shndërruese, një përjasje të re për jetën në bashkësi.

Megjithëse Gaviotas nuk është përqendruar në asetet tipike të trashëgimisë - si artefaktet apo strukturat e ndërtuara - bashkësia u nda qartazi nga rrëfimi traumatik kombëtar (apo trashëgimia) i përvojës kolumbiane për t’u angazhuar në sfida më të ngutshme rajonale. Mes arritjeve të tyre bën pjesë zhvillimi i teknologjive “të gjelbra” së bashku me një nga përpjekjet më intensive të pyllëzimit të ndërmarra në vend. Në këtë mënyrë, modeli i vërejtur në Gaviotas pasqyron përvojën e ZTK-së: Një trashëgimi e përbashkët traumatike mund të jetë katalizator për veprimtari shndërruese drejt zhvillimit të qëndrue-

<sup>1</sup> *Shumica e literaturës për historinë e Kolumbisë është botuar në spanjisht (p.sh. Junguito dhe Rincon 2004). Scheina (2003a; 2003b) ofron një histori ushtarake në gjuhën angleze të Amerikës së Jugut, ku jepen kontekste të rëndësishme për kuptimin e emergjencës në Kolumbi. Po ashtu, ekziston edhe një vëllim i madh i literaturës politike mbi Kolumbinë në gjuhën angleze (p.sh. Hundson 2010).*

shëm. Në hyrje të këtij libri, Weisman (2008) e paraqet kështu “arsyetimin” e Gaviotas:

“[Qëllimi i këtij libri është të] dokumentojë kërkimin e njerëzimit për zgjidhje përballë sfidave më të mëdha mjedisore dhe shoqërore që kërcënojnë njerëzimin. [Ky kërkim më çoi në një] vend të papëlqyer: në Kolumbinë e rrënuar nga lufta dhe shpartaluar nga droga. [në fund të viteve 1960 / fillim të viteve 1970] një grup vizionarësh kolumbianë vendosën që nëse mund të skiconin një paqe dhe begati të vetëqëndrueshme në vendin më të vështirë të botës, atëherë kjo gjë mund të bëhej kudo tjetër. Dhe iu vunë punës ta provonin (fq. iii)”.

### Kibbutz Lotan

I krijuar në vitin 1983, Lotan është një bashkësi e planifikuar në lëvizjen e gjerë izraelite kibbutz<sup>2</sup>. Kibbutzi ndodhet në pjesën lindore të shkretëtirës Negev, më pak se dy kilometra nga kufiri me Jordanin dhe gati 50 kilometra në veri të qytetit Eilat. Ka disa ngjashmëri interesante mes zhvillimit të Lotanit dhe tipareve të vërejtura nga Weisman (2008) në Gaviotas. Njësoj si Kolumbia, edhe Izraeli ndodhet në gjendje pothuajse të pandërprerë konflikti të armatosur gjatë këtyre 65 viteve të fundit. Vendi përballat edhe me sfida shoqërore, ekonomike dhe të <sup>2</sup> *Ka mjaft literaturë për historinë, zhvillimin dhe dinamikën e lëvizjes izraelite kibbutz. Lexuesit mund të përdorin Gavron (2000) dhe Near (2008) si pikënisje të mira për kërkime të mëtejshme.*

zhvillimit, në përgjithësi të shoqëruara me emergjencat pas-koloniale. Për Lotan-in, të gjitha këto ndodhin në mjedisin e ashpër të shkretëtirës në luginën Arava.

Në këtë kontekst, Lotani ka përshtatur nocionin biblik “tikun’olam” si parim thelbësor të bashkësisë. E përkthyer fjalë për fjalë, tikun’olam do të thotë “riparo botën”. Koncepti fetar i bashkëngjitur i shton një element normativ këtij kuptimi: është përgjegjësia kolektive e njerëzimit të ofrojë përkujdesje për botën.

Njësoj si Gaviotas, Lotani nuk është përqendruar te asetet tipike të trashëgimisë. Por bashkësia është përqendruar së tepërmi në përdorimin e përvojës së vështirë kombëtare hebraike (apo trashëgimisë), së bashku me parimet e veçanta të trashëgimisë hebraike (tikun’olam), për t’u angazhuar në përballjen me disa nga sfidat më të tmerrshme e të gjata të rajonit. Për shembull, në Lotan ndodhet Qendra për Ekologjinë Krijuese (<http://www.kibbutzlotan.com/creativeEcology/ga/index.htm>) dhe ofron një Program Mësimor të Gjelbër ku studentët mund të mësojnë bujqësinë e qëndrueshme dhe teknikat e ndërtimit. Këto programe synojnë edhe përfshirjen e çështjeve të paqes, drejtësisë dhe mjedisit. Një kurs i ofruar përmes Qendrës për Ekologjinë Krijuese përshkruhet në këtë mënyrë:

“Eksploro lidhjet mes formave të reja të identitetit ekologjik dhe përkujdesjes, drejtësisë sociale dhe bashkësisë në Izrael. Puno

krahas arabëve palestinezë, beduinëve dhe hebrejve izraelitë që synojnë paqen e drejtë e jetëgjatë. Fito përvoja praktike në dizajnin ekologjik, ndërtimet e gjelbra dhe bujqësinë e qëndrueshme. Vër në veprim permakulturën në gjendje autentike ndërkulturore (Kibbutz Lotan 2012)“.

Siç tregon citimi i mësipërm, roli i trashëgimisë në Lotan duket se është i lidhur nga afër me veprimtaritë e zhvillimit të qëndrueshëm. Si në shembujt e Gaviotas dhe ZTK-ve, koncepti i trashëgimisë ofron një lloj“kuadri organizues të njohjes” për kujdestari kolektive, sidomos në kontekstin e historive të vështira të përjetuara nga të dyja këto vende.

### Letonia: Ngadalë shijohet më mirë

Përvoja e Letonisë gjatë periudhës komuniste ishte e vështirë dhe traumatike. Shumë (në mos të gjitha) nga fermtat ishin shtetërore, shumë letonezë punonin nëpër kampet e punës në Siberi, gjuha letoneze nuk njihet për qëllime zyrtare dhe identiteti kulturor i popullit letonez në përgjithësi u shtyp<sup>3</sup>. Në kohën që shpërbërja e Bashkimit Sovjetik hapi dyert për “shfaqjen” e identitetit kulturor letonez, ajo solli edhe sfida të rindërtimit në këtë vend.

<sup>3</sup> Njësoj si në shembujt e tjerë të ofruara në këtë shkrim, historia social-politike e Letonisë ka shumë faqe dhe është e ndërlikuar. Lexuesve që kërkojnë informacione shtesë mund t’u vijë në ndihmë Eglitis (20020) për këtë temë.

Strategjia e Letonisë “Ngadalë shijohet më mirë” (http://www.latvia.travel/en) është një shembull tjetër i lidhjes së drejt-përdrejtë mes trashëgimisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, pas një historie të vështirë e traumatike. E hartuar enkas për ta pozicionuar Letoninë si destinacion për të shijuar përvoja të ngadalta e të orientuara nga gjërat e vogla, përpjekja “Ngadalë shijohet më mirë” mbështetet në vlerat e cilësisë, zhvillimit të qëndrueshëm, individualizimit, vlerave të shtuara dhe përvojave të bashkëkrijuara (Agjencia Letoneze e Zhvillimit të Turizmit, 2012).

“Ngadalë shijohet më mirë” është një strategji zhvillimi sa ndërkombëtare ashtu edhe kombëtare. Përmasa ndërkombëtare është e qartë: Letonia po kërkon të kapë tregun “e gjelber” në rritje, trashëgiminë dhe turizmin e ngadaltë, duke promovuar asetet e saj të dukshme e të padukshme. Shembujt përfshijnë gastronominë, festivalet tradicionale dhe peizazhet e pasura kulturore dhe natyrore.

Elementi vendas ndoshta ka më tepër nuanca. Përpjekja “Ngadalë shijohet më mirë” kërkon aktorë dhe institucione në gjithë vendin që të zhvillojnë ekspertizën në hartimin e qëndrueshëm, administrimin e trashëgimisë si dhe aftësi për të konkurruar në një sistem ekonomik global të mbështetur te

tregu. Siç u tregua shkurtimisht në shembujt për ZTK-të më sipër, trashëgimia mund të shërbejë si mjet i fuqishëm për të angazhuar organizata të ndryshme në zhvillimin e trashëgimisë, sidomos kur veprimtaritë për zhvillimin e trashëgimisë ndërthuren me histori të ndërlikuara dhe të vështira. Për Letoninë, kjo do të thotë të përdorë zhvillimin e saj të trashëgimisë për të kontekstualizuar historinë e saj dinamike në mënyra që fuqizojnë aktorët vendas. Ky fuqizim, nga ana e tij, mund të lehtësojë një varg të gjatë veprimtarish të orientuara nga trashëgimia dhe nga zhvillimi i qëndrueshëm. Agjencia Letoneze e Zhvillimit të Turizmit e përshkruan kështu procesin:

“Imazhi i ri letonez i turizmit mbështetet te ndryshimet e vlerave në Letoni dhe në vendet e tjera, [sidomos përsa i përket] konsumit. Vrapimi i shpejtë pas mirëqenies, dëshira për të qenë në kohë dhe më i mirë në çdo fushë ka pasur një efekt rraskapitës mbi njerëzit duke e bërë jetën e tyre më të turbullt se kurrë më parë... Letonia [mund të jetë një] vend ku [vizitorët] ndryshojnë hapin dhe jetën dhe shijojnë një pushim të qetë e plot nuanca. [Një vend] ku fitimi i përvojave të reja, gjetja e harmonisë dhe [përjetimi] i vlerave autentike janë të mirëpritura...”

Letonia nuk ka qenë dhe as do të jetë kurrë produkt i turizmit masiv... [Ne] ftojmë [vizitorët] të ngadalësojnë hapin e të shijojnë

një pushimin e ngadaltë e të orientuar nga hollësitë, si dhe të mendojnë për çështjet e rëndësishme në jetë. Vlerat themelore të “Ngadalë shijohet më mirë” janë besueshmëria, thellësia, lehtësia dhe vetërespekti për natyrën, kulturën dhe popullin e Letonisë (Agjencia Letoneze për Zhvillimin e Turizmit, 2012).

### Reflektime mbi trashëgiminë, dinamika e zhvillimit të qëndrueshëm

Si mund të lejojnë proceset e zhvillimit të trashëgimisë veprimet e kujdestarisë kolektive, veçanërisht në mjedise me histori të vështira dhe traumatike?

Një pikë nisjeje për të kuptuar këtë dinamikë besoj se gjendet te puna e teoricienit Donald Schön. Shumica e studimeve të Schönit përqendrohet te “praktika reflektuese” të cilën ai e përshkruan si aftësinë për të reflektuar mbi veprimet e dikujt për t’u angazhuar në një proces mësimi të vazhdueshëm (Schön 1983). Në punimin e tij themelor, “Praktikuesi reflektiv” (1983), Schöni e përshkruan praktikën reflektive si një mënyrë për të angazhuar praktikuesit (menaxhues, ofrues shërbimesh, vendim-marrës, etj.) në sfidat më të ngutshme të shoqërisë. Duke përdorur analogjinë e ecjes nëpër një moçal, Schöni shkruan:

“Në topografinë e larmishme të praktikës profesionale, ka te-

rrene të larta e të forta prej nga duket i gjithë moçali. Nga ky terren i lartë, problemet e menaxhueshme shtrihen për zgjidhje përmes zbatimit të teorive dhe teknikave të bazuara te kërkimet. Kurse në tokën moçalore, problemet e ngatërruara dhe të vështira i sfidojnë zgjidhjet teknike. Ironia e kësaj gjendjeje është se problemet në terrenin e thatë priren të jenë relativisht më pak të rëndësishme për individët apo shoqërinë, sado i madh të jetë interesi i tyre teknik, ndërkohë që në moçal gjenden problemet me interesin më të madh për njerëzit. Praktikuesi duhet të zgjedhë. Të rrijë në tokë të thatë ku mund të zgjidhë probleme relativisht të parëndësishme sipas standardeve mbizotëruese apo të zbresë në moçalin e problemeve të rëndësishme (fq. 42)?

Nocioni i Schönit për praktikën reflektuese mund të shpjegojë pse veprimtaritë e zhvillimit të trashëgimisë mund të shpien në ndryshim të bashkësisë (në rastin tonë, ky ndryshim shfaqet përmes përmirësimit në zhvillimin e qëndrueshëm). Zhvillimi i trashëgimisë është një proces i qenësishëm vetë-reflektimi që sjell shpesh mësimet e dituri të reja, të cilat i fuqizojnë aktorët që këta të kërkojnë zgjidhje të reja që u bëjnë ballë sfidave. Eksplorimi i trashëgimisë, dinamika e zhvillimit të qëndrueshëm ndihmon në pozicionimin e studimeve mbi trashëgiminë si një fushë me tema kritike jo vetëm për të ruajtur thesaret e së

shkuarës, por edhe për të trajtuar sfidat me rrënjë të thella të zhvillimit me të cilat përballemi në të ardhmen.

### Literatura e cituar

- Blewitt, J. 2008. Understanding sustainable development. Earthscan/James & James.
- Copping, S., P. Huffman, D. Laven, N. Mitchell, and J. Tuxill. 2006. Connecting stories, landscapes, and people: Exploring the Delaware & Lehigh National Heritage Corridor partnership. Sustainability study Report. A technical assistance project for the Delaware & Lehigh National Heritage Corridor Commission and the Delaware & Lehigh National Heritage Corridor, Inc. Woodstock, VT: USNPS Conservation Study Institute.
- Eglitis, D. S. 2002. Imagining the nation: History, modernity, and revolution in Latvia. Penn State University Press.
- Gavron, D. 2000. The kibbutz: Awakening from utopia. Rowman & Littlefield Pub Incorporated.
- Hudson, R. 2010. Columbia: A country study, area handbook series. Washington, DC: Federal Research Division, Library of Congress.
- Jewiss, J., D. Laven, N. Mitchell, and P. Huffman. 2008. Development of a National Heritage Area evaluation strategy: Report on phase I: A technical assistance report for the NPS National Heritage Areas Office. Woodstock, VT: Conservation Study Institute in cooperation with the NPS National Heritage Areas Office and the Alliance of National Heritage Areas.
- Junguito, R., Rincon H. 2004. "La politica fiscal en el siglo XX en Co-

lombia: Una vision global." Coyuntura Economica (Bogota) 34, no. 2 (2004): 53–75.

- Kaihla, P. (2007) The village could save the planet. Bus 2.0, 8:84–90.
- Kibbutz Lotan. 2012. Official website. <http://www.kibbutzlotan.com/creativeEcology/ga/index.htm> (accessed 27 December 2012).
- Latvian Tourism Development Agency 2012. Official website. <http://www.tava.gov.lv/en/latvian-tourism-image> (accessed 27 December 2012).
- Laven, D. 2006. Evaluating National Heritage Areas: Theory, methods, and application. Burlington, VT: Doctoral dissertation, University of Vermont.
- Laven, D. N., D. H. Krymkowski, C. L. Ventriss, R. E. Manning, and N. J. Mitchell. 2010a. From partnerships to networks: New approaches for evaluating US National Heritage Area effectiveness. Evaluation Rev. 34:271–298.
- Laven, D.N., Jewiss, J.L., and Mitchell, N.J. 2012. Toward Landscape-Scale Stewardship and Development: A Theoretical Framework of United States National Heritage Areas, Published on-line by Society & Natural Resources: An International Journal, DOI:10.1080/08941920.2012.723304
- National Park System Advisory Board. 2006. Charting a future for national heritage areas. Washington, DC: National Park System Advisory Board.
- Near, H. 1992. The Kibbutz Movement. A History (volume I): Origins and Growth, 1909-1939. Oxford UK: The Littman Library of Jewish Civilization.
- Pearce, J., Albritton, S., Grant, G., Steed, G., & Zelenika, I. 2012. A new model for enabling innovation in appropriate technology for sus-

tainable development. Sustainability: Science, Practice, & Policy, 8(2), 0901-002.

- Scheina, R. L. 2003. Latin America's wars. Dulles, Virginia, USA: Potomac Books.
- Scheina, R. L. 2003. Latin America's Wars Volume II: The Age of the Professional Soldier, 1900-2001 (Vol. 2). Dulles, Virginia, USA: Potomac Books.
- Schon, D. A. 1983. The reflective practitioner: How professionals think in action. New York, New York, USA: Basic Books.
- Tuxill, J., P. Huffman, D. Laven, and N. Mitchell. 2008. Shared legacies in Cane River National Heritage Area: Linking people, traditions, and culture. A technical assistance report for the Cane River National Heritage Area Corridor Commission. Woodstock, VT: USNPS Conservation Study Institute.
- Tuxill, J., N. Mitchell, P. Huffman, D. Laven, S. Copping, and G. Gifford. 2005. Reflecting on the past, looking to the future: Sustainability study report. A technical assistance report to the John H. Chaffee Blackstone River Valley National Heritage Corridor Commission. Woodstock, VT: USNPS Conservation Study Institute.
- Weisman, A. 1998. Gaviotas: A Village to Reinvent the World. White River Junction, Vermont, USA: Chelsea Green Publishing.
- Weisman, A. 2008. Gaviotas: A Village to Reinvent the World. 10th Anniversary Edition. White River Junction, Vermont, USA: Chelsea Green Publishing.

## Integriteti vizual dhe trashëgimia kulturore

Nga Ekphrasis Studio | Prizren

Blerina Berberi, Kevin Tummers

Koncepti i “integritetit vizual” është diskutuar në një takim ndërkombëtar ekspertësh të UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore në vitin 2013. Sipas udhëzimeve operuese të UNESCO-s, përfrimi më i ngushtë i integritetit vizual është paragrafi 104 i seksionit II.F që ka lidhje me “pikëpamje të rëndësishme”. Aty thuhet se duhet të përfshihen “zonat ose atributet që janë funksionalisht të rëndësishme si mbështetje për pronën dhe mbrojtjen e saj”. Në këtë mënyrë, duhet mbajtur parasysh shumë më tepër se thjesht prona për të mbështetur promovimin dhe rigjallërimin e trashëgimisë kulturore.

A duhet t’i konsiderojmë si të rëndësishme pamjet që shohim çdo ditë? Po. Veç kësaj, besojmë se “atributet që janë funksionalisht të rëndësishme si mbështetje për pronën dhe mbrojtjen e saj” mund të përfshijnë në vetvete edhe produkte si veprat e artit, posterët e suvenirët, të cilat mund të mbështesin ruajtjen e pamjeve të rëndësishme si me mbledhje fondesh ashtu edhe me rritjen e ndërgjegjësimit. Kështu, krijimi dhe mirëmbajtja e integritetit vizual mund të shihet si mënyrë për të mbajtur dhe nxitur trashëgiminë, pamjet e objektet në hapësirat publike, për të treguar historinë e trashëgimisë sonë dhe për të ndihmuar nxitjen e ekonomisë.

Në një kohë kur Shqipëria ka plot trashëgimi kulturore, ka njëherësh edhe mjaft zhvillim modern dhe një shkëputje të përgjithshme mes këtyre të dyjave. Njëra, për nga vetë natyra, priret ta frenojë tjetrën. Në rastin e Beratit, zhvillimi i ri është frenuar nga përcaktimi i qytetit si Qytet Muze Shqiptar dhe Trashëgimi Botërore e UNESCO-s për shkak të arkitekturës karakteristike otomane. Tirana, nga ana tjetër, po e humbet me shpejtësi trashëgiminë për shkak të zhvillimit, së bashku me arkitekturën historike për hir të strukturave moderne.

Megjithëse i mbrojtur, Berati nuk është i imunizuar ndaj modernizimit dhe shumë nga banesat karakteristike të qytetit shfaqin për fat të keq tipare jo-autentike siç janë depozitat e ujit, marrësit satelitorë dhe koshat e mbeturinave që e trazojnë panoramën e rëndësishme. Për të ruajtur integritetin vizual të beratit nevojiten ndërhyrje të menduara, të cilat mund të jenë edhe të thjeshta si fshehja e këtyre tipareve për t’u shkrirë me të, për shembull, lyerja e depozitave të ujit që të ngjajnë me çatitë me tjegulla të kuqe apo gjethet e hardhive. Anasjelltas, Tirana mund të bëjë të kundërtën dhe t’i theksojë marrësit satelitorë dhe depozitat e ujit si punime bashkëkohore artistike apo paraqitje të simboleve të trashëgimisë. Në këtë mënyrë, mund

të krijohet një trashëgimi e re kulturore dhe të vendoset një farë marrëdhënieje vizuale. Shembuj mund të gjenden në gjithë botën, nga Sidnej, Australi, i cili tani ka një regjistër bashkiak të muraleve për të mbrojtur artin ikonik të mureve, deri në Nju Jork ku depozitat funksionale të ujit janë kthyer në një simbol dominues kulturor të qytetit dhe janë krijuar ligje të reja lidhur



Mundësuar nga Ekphrasis Studio

me përdorimin e tyre apo janë hapur ekspozita për të treguar historinë e tyre. Për ta arritur këtë, ka nevojë për një partneritet më të madh publik-privat dhe më tepër vetëbesim për të ruaj-

tur dhe krijuar trashëgimi kulturore në Shqipëri. Në këtë drejtim është bërë mjaft punë nga organizata ndërkombëtare si CHwB dhe priten rezultate shtesë nga krijimi i Shoqatave Lokale të Përmirësimit të Biznesit, që sot gati nuk ekzistojnë. Një sfidë tjetër është financimi i cili mund të vijë në formën e uljes së taksave për kujdesin privat ndaj trashëgimisë. Duhet rishqyrtuar edhe disa ligje duke i përditësuar. Kur të ekzistojë partneriteti i fortë publik-privat do të ketë edhe mundësi më të mëdha për trajtimin e çështjeve dhe zgjidhjen e problemeve që kanë lidhje me integritetin vizual në Shqipëri. Pamjet janë mjete të rëndësishme për komunikimin, ruajtjen dhe promovimin e kulturës sonë por ligji shqiptar nr. 9048 mbi trashëgiminë kulturore (neni 16.2) që thotë se objektet muzeale nuk mund të fotografohen apo riprodhohen pa lejen e Ministrisë së Kulturës e kufizon aftësinë e qytetarëve për t’u përfshirë. Kjo lloj pronësie mbi pamjen e kufizon nga ana e saj aftësinë e shpërndarjes vizuale të trashëgimisë sonë kulturore. Projekte të tilla si [www.ShareCulture.eu](http://www.ShareCulture.eu) dhe thirrja jonë drejtuar qytetarëve për të lyer depozitat e ujit, marrësit satelitorë, shtyllat e kutitë e shpërndarjes së energjisë, synojnë t’ua kthejnë këtë aftësi qytetarëve.

Për më tepër informacion, vizitoni: [Water in the City](http://ekphrasisstudio.com/2012/10/19/water-in-the-city-berat-and-gjirokastra/) <http://ekphrasisstudio.com/2012/10/19/water-in-the-city-berat-and-gjirokastra/>

## Nga ndërhyrja shpëtuese te biznesi social: zhvillimi i një përqsasjeje të integruar për të shpëtuar qytetin e gurtë

Nga Sadi Petrela | Gjirokastra

Historia e Fondacionit Gjirokastra (FGJ) ilustron zhvillimin e një organizate të vogël që nisi para 11 vjetësh, kur u krijua fillimisht si përgjigje pozitive nga Packard Humanities Institute ndaj kërkesës SOS për ndihmë për shpëtimin e Gjirokastrës lëshuar nga Presidenti i Republikës i asaj kohe, Rexhep Meidani. Në atë kohë, qendra historike e Gjirokastrës ishte në gjendje jashtëzakonisht të vështirë, duke vuajtur mungesën gati të plotë të investimeve për ruajtjen e saj prej më tepër se 20 vjetësh. Duheshin miliona e miliona dollarë për të ndalur rrënimin e 600 shtëpive monumentale, të veshjes së gjithë qytetit dhe rrugëve me kalldrëm dhe kështjellës së madhe.

Pas ndryshimeve dramatike politike, ekonomike dhe sociale që ndodhën me rënien e regjimit komunist, Shqipëria ndodhej në gjendje të vështirë. Kjo detyrë dukej si përtej çdo mundësie reale. Nga ana tjetër, në kushtet e demokracisë së sapovendosi dhe një ekonomie tregu (që pasuan një kursim të skajshëm spartan gjatë 50 viteve komunizëm), vendi njohu etjen për një jetë moderne e më të rehatshme: dukej se kjo prirje ishte në kundërshti të ashpër me nevojën për ruajtjen e ndërtesave të vjetra. Sidomos pas trazirave civile të 1997-ës, qyteti vuajti

shpopullimin nga qytetarët e pashpresë që emigruan jashtë vendit ose u larguan drejt Tiranës ose, të paktën, u përpoqën të zhvendoseshin drejt pjesës moderne të qytetit. Kërkesa e presidentit ishte “të bëhej diçka për të shpëtuar” trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës. Dhe kjo ishte pikënisja e Fondacionit Gjirokastra.

Veprimtaria e FGJ-së mund të ndahet skematikisht në tri faza. Duke nisur si mjet për dhënien e një farë ndihme në shpëtimin e trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës, ai u rrit vit pas viti duke kaluar nga ndërhyrjet shpëtimtare drejt përqsasjeve të integruara dhe pjesëmarrëse në administrimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin nga një zyrë emergjence filantropike drejt një sipërmarrjeje sociale dhe një biznesi të ardhshëm social.

**Faza e parë (2001-2007) Ndërhyrjet shpëtuese dhe filantropia për të sjellë një farë shprese te bashkësia lokale, duke shërbyer si ndërmjetës mes nevojave sociale dhe burimeve financiare**

FGJ-ja (që atëherë quhej Zyra për Ruajtjen e Gjirokastrës) nisi punë me një varg veprimesh të vogla dhe me shumë pak pará.

Synonte të kthente pak shpresë dhe të mobilizonte bashkësinë. U ndërmorën një sërë veprimesh: pastrimi i hapësirave publike, veprimtari publike me rastin e Ditës së Monumenteve, ditët e hapura të Trashëgimisë Kulturore, Ditën e Muzeve, diskutime publike mbi nevojat e ruajtjes, etj. Disa ndërhyrje urgjente shpëtimi dhe ruajtjeje u kryen në hapësirat publike, në rrugët me kalldrëm dhe ndërtesat private. Duke punuar me sloganin “Pasion e durim” organizata ku bënë pjesë njerëz vendas dhe nga Tirana dhe e cila asistojë nga ekspertë ndërkombëtarë, krijoi një përvojë dhe emër të mirë brenda bashkësisë. Përmes përfshirjes së bashkësisë u zhvilluan disa plane për ruajtjen e qytetit historik dhe turizmit, të cilat u shoqëruan me disa publikime.

Për herë të parë, rivitalizimi (që do të thotë rikthimi i jetës dhe veprimtarisë në ndërtesat e braktisura dhe rrënuara) u kthye përmes restaurimit të ndërtesës historike te Obelisku, që atëherë përdorej si qendër për ruajtjen e qytetit. Organizata luajti një rol kyç për përgatitjen e dosjes për aplikimin e Gjirokastrës në UNESCO që qyteti të futej në listën e vendeve të trashëgimisë botërore. Ky emërtim ishte një hap i rëndësishëm

në rrugën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore të qytetit. Në vitin 2007, organizata ndryshoi status: nga një agjenci zbatimi e një donatori ndërkombëtar në Organizatë Shoqërore Civile Shqiptare të regjistruar në vend.

**Faza e dytë (2007-2012) Rivitalizimi përmes futjes së skemës novatore sociale, mbledhjes së fondeve dhe vendosjes së partneritetit publik-privat**

Shembuj më të plotë të revitalizimit të ndërtesave historike përmes përfshirjes së qytetarëve u kryen në vitin 2007. Si përfundim, shtëpia e Zekatëve, e trajtuar nga pronarët, hapi dyert për vizitorë si një nga shembujt e shtëpive tipike gjirokastrite, duke u bërë shumë shpejt pika e tretë më e vizituar e qytetit. Më pas u revitalizua shtëpia e Omaratëve - në zemër të pazarit mesjetar të Gjirokastrës u krijua një qendër zejtare që më pas gjeneroi një varg veprimtarish. Hap pas hapi, revitalizimi i trashëgimisë së ndërtimit u formalizua dhe zbatua përmes qa-sjes pjesëmarrëse duke bashkuar ente publike, donatorë ndër-kombëtarë, qytetarë, pronarë ndërtesash historike dhe bashkësinë. Një program i gjerë përmes partneritetit u zhvil-

lua te Kalaja ku, në 5 vjet, si rezultat i zbatimit të suksesshëm të disa projekteve, ajo u bë më e pastër, më tërheqëse, e ruajtur më mirë, e studiuar më mirë, e shpjeguar dhe interpretuar më mirë për vizitorët, e ndriçuar më mirë me energji diellore. Së fundi, në shtator 2012, në një nga galeritë më të bukura të saj u ndërtua muzeu i ri i Gjirokastrës dhe luginës së Drinosit. Një shembull tjetër ishte programi 5 vjeçar i zhvillimit të zejtarisë me produkte të zhvilluara që organizon për të gjashtin vit me radhë panaire zejtarie në rrugët e kalldrërta të pazarit, etj.

Në 11 vjet veprimtari, FGJ-ja i ka përmirësuar kapacitetet e veta duke dhënë një ndihmesë të çmuar në përmirësimin e gjendjes së ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore, në revitalizimin dhe administrimin e Gjirokastrës përmes:

- Konceptimit dhe zbatimit të gati 50 projekteve të një shumëllojshmërie të madhe
- Dhënies përmes mbledhjes së fondeve të gati 2 milionë Eurove nga më tepër se 20 donatorë/investitorë (ndërkombëtarë, publikë, privatë)

Dhe profili i organizatës në shkallë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Gjatë 2012-ës, FGJ-ja ka punuar me 4 projekte të rëndësishme, dy prej të cilave të financuara nga BE-ja.

### Faza e tretë (2012 e në vazhdim) Sfida e madhe e zhvillimit të qëndrueshëm të organizatës

Tani, gjendja e ruajtjes, restaurimit dhe revitalizimit të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës historike është përmirësuar dukshëm. Por sfida e vështirë, e ndërlikuar dhe e madhe e shpëtimit të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës ende mbetet për t'u përballuar. Tani janë të nevojshme përqasje të integruara në shkallë qyteti. Janë pjekur kushtet për të krijuar dhe zbatuar plane menaxhimi të integruara (së shpejti do të botojmë një udhërrëfyes mbi këtë çështje, ku do të sjellim përvojat më të mira ndërkombëtare), të cilat do të trajtojnë çështje të rëndësishme si ndërtimet e paligjshme, rritjen e kapaciteteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit.

Vitet e fundit, slogani i FGJ-së është pasuruar më tej, mbështetur në përvojat e reja të organizatës. Durim, pasion, partneritet dhe trysni - slogani i përditësuar - u shpalos gjatë zbatimit të dy projekteve të financuara nga BE-ja. Me EVAH (European Values in Heritage), standardet, rregullat dhe rregulloret e BE-së për administrimin e qyteteve historike u bënë të njohura për vendimarrësit e 4 vendeve: Shqipërisë, Greqisë, Kosovës dhe Maqedonisë, përmes një vargu veprimtarish dhe botimesh të vëna në jetë nga një konsorcium prej 4 OJF-sh rajonale. Për më tepër, lexoni në [www.euheritagevalues.org](http://www.euheritagevalues.org).

Përmes REVATO, qytetari dhe shoqëria civile përfshihen në çështje tepër të rëndësishme të organizimit dhe vetorganizimit, mbledhjes së fondeve për trashëgiminë kulturore, zgjedhjes së problemeve të administrimit etj. ([www.revato.info](http://www.revato.info)). Me këto dy projekte, organizata ka dhënë ndihmesë duke paraqitur hapa të reja drejt përgatitjes së një plani real të integruar administrimi për qytetin e Gjirokastrës.

Një program trevjeçar bashkëpunimi i Fondacionit Gjirokastra me Trashëgiminë Kulturore pa Kufij (CHWB), Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe familjen Babameto është tani pranë përbashkjes. Marrëveshja është që pas financimit dhe punës së përbashkët për revitalizimin, dy ndërtesa shumë të rëndësishme që i përkasin familjes Babameto do të përdoren falas për 5 vjet nga FGJ-ja. Pas përfundimit të restau-

rimin, FGJ-ja po punon që të revitalizojë ndërtesat duke krijuar një Qendër kulture dhe Trashëgimie dhe një Qendër Zejtarije në zemër të pazarit të Gjirokastrës. Të drejtuara si biznese sociale, ndërtesat do të jenë një mjet i fuqishëm për mbledhjen e fondeve për projekte të tjera në dobi të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës si dhe për të krijuar qëndrueshmëri për organizatën.

Në diagramin e tretë është e qartë se në veprimtarinë e FGJ-së është futur një element i ri: fitimi. Ai do të shkojë për trashëgiminë kulturore të Gjirokastrës dhe për të ofruar qëndrueshmëri për FGJ-në e cila, pa pikë dyshimi, e ka provuar veten se është një aset i rëndësishëm në përballjen me sfidën e madhe të shpëtimit të qytetit historik të Gjirokastrës.



## Trashëgimia dhe turizmi në Ballkan: a është trashëgimia kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për turizmin në Ballkan?

Nga David Prince | Prizren

Duke ndjekur një përjasje gjithëpërfshirëse, kjo trajtesë hedh një vështrim mbi rrugët në të cilat është përkufizuar dhe përdorur “trashëgimia”, si në Ballkan edhe gjatë, dhe shtron pyetjen nëse ajo ofron një kusht të nevojshëm e të mjaftueshëm për turizmin apo, nëse jo, çfarë mund të kërkohet tjetër për ta përdorur trashëgiminë si një mjet të tillë.

Eksplorohe dy anë qendrore të trashëgimisë (“gjërat” dhe “mendimet” - fizike e jofizike) dhe shqyrtohen mënyrat me të cilat të parat kthehen në reale përmes të dytave. Shembujt nga përvoja e vetë autorit [Stonehenge, pushtimi norman, flota spanjolle, revolucioni industrial dhe Lufta e Parë dhe ajo e Dytë Botërore] përdoren për të vërtetuar pikëpamjen se trashëgimia nuk është gjithmonë pozitive - është një ngrehinë që mund (dhe është) përdorur në mënyra pozitive dhe negative. Thuhet se ajo çka është përzgjedhur për tu ruajtur dhe interpretuar flet më shumë për ata që kanë marrë vendimet – dhe për pushtetin e tyre - sesa për vetë objektet [Tregu i skllevërve të ishullit Kaiwah, Karolina e Jugut; Vendi i trashëgimisë botërore Ironbridge Gorge apo fati i Nikolai Ivanoviç Jezhovit, ish shefi i policisë së fshehtë sovjetike jepen si shembuj të kësaj].

Pasi ngre skenën, trajtesa bën më pas një hyrje në konceptin e “ekologjisë së turizmit” si mjet për trajtimin e temës qendrore. Në këtë model të ri të propozuar ekologjik, turistët dhe shërbimet turistike shihen si organizma që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin fizik, duke krijuar një sistem dinamik. Shihen si pjesë të mjedisit, jo si shtojca të tij: si lojtarë, jo si shikues. [Jepen shembuj nga Himalajet, Luksori, Athina, plazhi Hjudson dhe Kosta del Sol].

Modeli sugjeron që çdo ngjarje e re në ekosistem ka ndikim mbi pjesën tjetër të sistemit, duke ndryshuar kështu gjendjen e baraspeshës. Baraspesha, si në natyrë, arrihet përmes përshtatjes ekologjike (në këtë rast, edhe përmes ndryshimit (përshtatjes) në produktin e turizmit, mjedisit fizik, tregut apo të triave bashkë), ose baraspesha e re mund të mos arrihet, duke çuar në shuarjen e sistemit dhe zëvendësimin e tij me një tjetër. Në të vërtetë, evolucioni nuk ka as plan dhe as motive - thjesht është sepse kështu është. Dhe ngaqë nuk ka as plan dhe as motive, të gjitha skenarët e ardhshëm janë të mundshëm. Trajtesa shtron pyetjen se, ngaqë sistemi ekologjik i turizmit mund të vazhdojë të zhvillohet dhe ndryshojë (njësoj si vetë evolucioni),

a mund të administrohet ky ndryshim për të nxjerrë përparësi? [Jepen shembuj nga Kalifornia, ishujt Galapagos, Diego Garsia dhe Binhai].

Aspekti i parë i kësaj ekologjie që po shfaqet - vetë turistët - merret në shqyrtim në nivelin global të anëtarëve të turizmit (vlerësuar si 1 miliard në vitin 2012 - “kushdo që mund të jetë turist, është turist”) së bashku me ndikimin mbi mjedisin që vizitojnë ata. Ai vë në pikëpyetje përdorimin e politikës së Organizatës Botërore të OKB-së për Turizmin që thotë “udhëtarët të lihen të mësojnë si mund të përfitojnë më mirë nga njerëzit dhe vendet që vizitojnë” duke mbajtur parasysh se ku bien konkretisht këto përfitime dhe ndikimin shkatërrimtar të infrastrukturës që kërkohet për të mbështetur sa më tepër udhëtime turistike. Për vitin 2020 është projektuar një shifër prej 2 miliard turistësh me një rritje që vjen nga ekonomitë me rritje të shpejtë si nga Kina, Rusia, Brazili dhe India. Kjo trajtesë argumenton se pranimi dhe përshtatja me këtë prirje do të jetë sfida kyçe për “ofruesit e turizmit të trashëgimisë” (për të cituar OBT-në e OKB-së) gjatë viteve në vijim. Në fakt, mënyra se si do të jepet kjo përgjigje do

të përcaktojë mirëqenien e shumicës së burimeve të trashëgimisë kulturore të botës që tani e më pas, përfshi edhe ato të Ballkanit.

Aspekti i dytë - zgjedhjet që mund të bëhen nga ofruesit e përvojave turistike - shihet duke iu referuar tri mundësive: turizmit masiv, eko-turizmit dhe turizmit të trashëgimisë (ose kulturor). Trajtesa nuk është përshtatëse; ajo shtron një varg çështjesh në kontekstin e tri zonave kryesore të impaktit (lokale, turistike dhe planifikuese e zhvilluese) që duhen trajtuar para se të merren vendimet mbi produktin e turizmit dhe, si rrjedhojë, para se të projektohen impaktet e tyre relative mbi mjedisin (sociale, ekonomike, fizike, politike dhe kulturore). [Ofrohen si shembuj Kështjella e hirushes në Walt Disney, një kodër e fortifikuar e Epokës së Hekurit në Anglinë Jugore dhe eko-turizmi në Suedi].

Trajtesa fokusohet më pas më tepër në specifikën e ekologjisë të turizmit të Ballkanit dhe e sheh në terma të ekologjisë fizike dhe kulturore dhe sugjeron që - nëse merren së bashku - ato krijojnë dhe ruajnë një sens të veçantë të vendit. Ky sens i vendit i lidh njerëzit me vendin përmes të njëjtëve elementë fizikë

e jofizikë të përshkruar në shënimet hapëse: tiparet e peizazhit, rugët e format urbane, festivalet, baret, dyqanet, vallet, këngët.

Megjithatë, është e qartë se ekologjia e turizmit në Ballkan ndodhet nën trysni nga një masë (apo botë) në rritje (dhe në forcim) kulture e masave e mbizotëruar nga markat, nga çështjet e konvergjencës kulturore dhe përshtatjes kulturore, globalizimi, “tërheqja drejt Perëndimit”, mbizotërimi i anglishtes si gjuhë botërore dhe përshtatja me standardet e komunikimit mbarëbotëror (sidomos atij dixhital). Ndërkohë që mund të vihet në pikëpyetje e gjithë baza etike e gjithë kësaj, ndikimi i saj është i qartë dhe në rritje. [McDonald’s, Nike, Marlboro, Apple, Google dhe Coca-Cola përdoren si shembuj të markave botërore; Burger King dhe bllokimi i trafikut përdoren për të treguar konvergjencën kulturore; përshtatja kulturore tregohet përmes përdorimit të Harkut të Triumfit në Romën perandorake, Paris, Ohajo dhe Teheran, së bashku me kullat e lakuara në Sarajevë dhe Dubai; zhvillimi tepër i shpejtë që çon në shkatërrimin e qyteteve historike tregohen përmes zhvillimeve në gjirin e Dubait që nga viti 1990].

Trysnia mbi vendimarrësit për turizmin e trashëgimisë në Ballkan theksohet edhe më tej po të mbahen parasysh projektimet e botës për vitin 2030: 8-9 miliardë njerëz me rritje të qyteteve; popullata urbane e botës do të dyfishohet; më pak të rinj, më tepër të moshuar: mbi 80-vjeçarët do të katërfishohen, mbi

60-vjeçarët do të trefishohen në të gjitha qytetet; vendet e pasura do të kenë relativisht më pak popullsi, vendet e varfra relativisht më shumë. Kërkesa për ujë të pijshëm mund të dhjetëfishohet, krahas efekteve globale të ndryshimeve klimatike. Trajtesa thekson se mënyrat me të cilat do të përshtaten vendet e rajonet me këto ndryshime të thella do të ndikojnë mbi jetën e përditshme të gjithkujt në planet dhe se “trashëgimia” do të jetë pjesë e kësaj përshtatjeje, përndryshe do ta humbasë kuptimin dhe vlerën e saj.

Trajtesa shkon më tej duke parë drejtuesit e turizmit të trashëgimisë (të cilët i sheh si psikologjikë, socialë dhe ekonomikë) dhe prej tyre ndërton një pamje të një “turisti të trashëgimisë” (ndoshta) stereotip përse i përket mënyrës së jetesës, demografisë dhe qëndrimeve: gjëra që kanë të gjitha ndikim mbi mundësitë e ofruara dhe përvojat. Kurse mundësia nëse ekonomia e turizmit të trashëgimisë do të përdoret apo jo si mjet vendimmarrës shtjellohet përmes shembullit të arinjve polarë të Kanadasë.

Argumentet bëhen së bashku në një pjesë që shqyrton implikimet për turizmin e trashëgimisë në Ballkan ku theksohet se të treja aspektet e modelit - ai psikologjik, social dhe ekonomik - janë njësoj të rëndësishëm. Asnjë element nuk vlen më tepër apo më pak se tjetri: të gjithë janë të nevojshëm, të gjithë të ndërlidhur, të gjithë duhet të jenë të pranishëm. Nga kjo per-

spektivë, të gjithë (pronarë restorantesh, udhëheqës grupesh turistike, staf hotelierik, shoferë taksish, personel baresh) janë pjesë e ekologjisë së turizmit të trashëgimisë: njerëzit janë po aq të rëndësishëm sa vendet. Duke u mbështetur në shembuj nga bota reale, më tej pyetet nëse në Ballkan nevojiten strategji kombëtare apo ndoshta rajonale për të nxjerrë në pah nismat e zhvillimit dhe për të ngritur kuadrin për projekte të përbashkëta.

Duke përdorur si model kriteret e sapobotuara të Bankës Botërore për Menaxhimin e Riskut për Zhvillimin (2014), trajtesa përmbillet duke deklaruar se, për të patur vlera reale dhe afatgjata, turizmi i trashëgimisë në Ballkan duhet të drejtohet lokalisht, të financohet lokalisht, të administrohet lokalisht

dhe të zhvillohet lokalisht. Trashëgimia si koncept - dhe si realitet fizik - sigurisht është e nevojshme. Megjithatë, në vetvete, trashëgimia nuk është e mjaftueshme. Nevojiten edhe vizione afatgjata dhe një menaxhim i qëndrueshëm dhe i aftë për ta mbrojtur dhe për t’ua komunikuar vlerat e saj të tjerëve, si vendasve ashtu edhe turistëve. Dhe pikërisht ky proces që krijon këtë vizion është shpesh po aq i rëndësishëm sa vetë vizioni - ai mund të jetë thirrja e kushtrimit që mund ta ndjekin pas shumë gjëra të tjera.





## Thesari im sekret: të lidhesh komunitetin, trashëgiminë dhe muzetë

Nga Višnja Kisić | Prizren

Thesari im sekret ishte projekti i parë i përbashkët i platformës Herty Fair<sup>1</sup>, realizuar gjatë viteve 2011 dhe 2012, me synim kthimin e trashëgimisë të njerëzimit dhe kthimin e njerëzve në muze. Idetë udhëheqëse të projektit ishin:

- Ruajtja dhe përdorimi i trashëgimisë nuk është një e drejtë dhe përgjegjësi vetëm e institucioneve, por e çdo individi.
- Trashëgimia nuk ka të bëjë vetëm me objektet muzeale, por edhe me përvojën dhe mozaikun e kujtimeve tona, të historive, hapësirave publike e private.
- Muzeu nuk është i kufizuar vetëm të ndërtesa dhe koleksionet e tij, por përfshin edhe idetë e veprimet.

<sup>1</sup> Herity Fair është një platformë për bashkëpunim në dokumentimin, studimin, interpretimin, paraqitjen dhe komunikimin e trashëgimisë së Serbisë Jugperëndimore. Platforma shërben si mjet për programin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe burimeve të muzeve lokalë dhe rajonalë në Serbinë Jugperëndimore si dhe për bashkëpunimin mes gjithë institucioneve, organizatave, bashkësive e individëve të interesuar për trashëgiminë e këtij rajoni. Synimi afatgjatë i platformës është ta bëjë trashëgiminë e Serbisë Jugperëndimore më të dukshme, një element të njohur dhe aktiv të jetës së përditshme të banorëve lokalë dhe ta përdorë atë për zhvillim të qëndrueshëm shoqëror, kulturor, njerëzor dhe ekonomik në këtë rajon. Mjete kyçe të bashkëpunimit dhe komunikimit brenda platformës janë seminarët, faqja e Internetit [www.varasbastine.com](http://www.varasbastine.com) dhe projektet e përbashkëta.

Thesari im sekret përfshinte qytetarë nga Serbia Jugperëndimore në një proces mbledhjeje, interpretimi dhe paraqitjeje të trashëgimisë nga rajoni, duke krijuar një koleksion online të trashëgimisë së tyre personale. Projekti kishte të bënte me seminare me fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme, interviste me të moshuar, një koleksion/bazë të dhënash online në adresën [www.vasar-basine.com](http://www.vasar-basine.com) si dhe ekspozita me muzetë partnerë së bashku me komunitetet lokale.



Mundësuar nga Višnja Kisić

Elementi thelbësor i seminareve, intervistave dhe ekspozitave ishte dosja e “thesarit tim sekret” e modeluar sipas dosjeve të objekteve muzeale, e cila ofronte informacione bazë për origjinën dhe pamjen e objekteve<sup>2</sup>. Dosjet e plotësuar pasqyronin

<sup>2</sup> Secila dosje ka dy pjesë. Pjesa e parë duhet plotësuar gjatë seminareve me fëmijët në shkollë, ndërsa jepnin propozime për thesarin e tyre të fshehtë, duke i vënë emrin, duke e paraqitur të vizatuar apo fotografuar dhe duke shpjeguar pse mendonin që ishte i rëndësishëm dhe se duhet vendosur në muze. Pjesa

njerëzimit që jetojnë në këtë rajon - vlerat e tyre, mendimet, kujtimet, arsimin, marrëdhënien mes tradicionales dhe modernes, nostalgjinë, emocionet dhe monumentet historike kyçe në jetët e individëve dhe bashkësive - në mënyrë shumë më të gjallë nga sa e kishin bërë më parë muzetë partnerë. Në këtë proces, muzetë nuk ishin më zëri autoritar që asnjëherë zërin individual, të brendshëm dhe emocional - ata luajtën rolin e ndërmjetësit të kujtimeve, duke hedhur dritë dhe kanalizuar zërat e

*e dytë duhet plotësuar nga anëtarët e moshuar të bashkësisë që plotësonin propozimet e fëmijëve, por edhe propozonin thesaret e tyre të fshehta.*



Mundësuar nga Višnja Kisić

individëve në bashkësi përmes një marrëdhënieje të hapur.

Gjithsej 821 persona, nga të cilët 616 fëmijë dhe 205 të rritur, morën pjesë në projektin Thesari im i fshehtë duke regjistruar trashëgiminë e tyre vetjake në 390 dosje. U hapën 5 ekspozita në secilin nga 5 muzetë rajonale me një total prej 12.000.



## Reflektime mbi Kampin e 15-të Rajonal të Restaurimit në Kosovë

Nga Stefanie White | Prizren

Në tetor 2013, Trashëgimia Pa Kufij (HWB) dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) organizuan së bashku një kurs konservimi dhe restaurimi në qytetet e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, Kosovë. Kursi përbënte Kampin e 15-të Rajonal të Restaurimit të organizuar nga CHwB-ja dhe i pari ku mernte pjesë HWB-ja.

Kampi 10-ditor i restaurimit synonte të zhvillonte aftësitë në konservimin parandalues dhe të ndihmonte pjesëmarrësit për të menduar lidhur me trashëgiminë në kontekst dhe për të kuptuar forcat e ndryshme që ndikojnë mbitrashëgiminë: dizajni

strukturor, mjedisi, lëndët e pranishme, proceset dëmtuese, ndikimi i përdorimit. Duke iu mundësuar leksione si dhe veprimtari praktike çdo ditë, pjesëmarrësve nga gjithë Ballkani iu ofrua një përvojë e veçantë në fushën e trashëgimisë dhe arkitekturës. Për profesionistët e trashëgimisë, HWB-ja ofroi trajnime për konservimin e objekteve dhe muzeve në muzeun e qytetit të Mitrovicës, ndërsa CHwB-ja ofroi trajnime për studentët e arkitekturës lidhur me dokumentimin dhe interpretimin e urës historike në Vushtrri.

Duke gërshetuar teorinë me praktikën, pjesëmarrësit fituan njohuri dhe aftësi për të kryer me vetëbesim konservimin parandalues dhe konservimin restaurues mbi një varg materialësh ku u përqendrua kursi: tekstil, qeramikë, lëndë organike

dhe inorganike. Pjesëmarrësit zhvilluan po ashtu aftësi për të plotësuar dokumentacion të plotë për katalogim, për të hartuar raporte dhe për të kryer vëzhgime për kushtet e objektit. Fryma e përgjithshme e kursit ishte ndërgjegjësimi për konservimin parandalues dhe restaurues, asimilimi i sëcilës nga pjesëmarrësit u shpreh qartë dhe përmes prezantimeve të tyre në ceremoninë përmbyllëse.

U hartua një plan menaxhimi konservues për muzeun mikpritës të qytetit të Mitrovicës. Objekte nga koleksionet e muzeut morën trajtim konservues, përfshi gjithë koleksionin numizmatik, disa tekstile, qeramika, tri palë këpucë tradicionale dhe dy shpata. U plotësuan raporte për trajtimin konservues dhe forma të tjera dokumentacioni (formularë regjistrimi objektësh) së bashku me fotografitë shoqëruese, të cilat u panë si ndihmesë për muzeun. Në muze u krijua një zonë ruajtjeje ku të gjitha materialet e përdorura gjatë kampit u lanë për përdorim në të ardhmen.

Kampi ia doli mbanë të arrinte qëllimin e synuar dhe përfundimet e mësimet. Për më tepër, ai lehtësoi kontaktet dhe nxiti marrëdhëniet mes konservatorëve vendas dhe ekspertizës nga njëra anë dhe profesionistëve të trashëgimisë e studentëve nga rajoni i Ballkanit nga ana tjetër, si dhe me Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën.



**Trashëgimia dhe përjasjet frymëzuese**



## Muzetë dhe të drejtat e njeriut

Nga David Fleming | Prizren

Ndoshta 30 milionë njerëz mbahen në skllavëri në botën moderne; shumë produkte konsumi, si kafeja, pambuku, frutat dhe orizi, kanë lidhje me praktikat e punës së detyruar në 58 vende të botës. Veç skllavërisë dhe punës së detyruar, ka edhe shumë shkallë të tjera të mohimit të të drejtave të njeriut, përfshi shtypjen e indigjenëve, të grave, të emigrantëve dhe pakicave.

Muzetë mund të jenë një forcë e madhe në luftën kundër abuzimit me të drejtat e njeriut. Nga publiku në mbarë botën shihen me konsiderate si vende ku mund të eksplorohen idetë. Muzetë janë një mjet i fuqishëm edukimi, sidomos kur lidhen me njerëzit dhe historitë e veçanërisht kur gjejnë një zë emocional. Për më tepër, muzetë nuk përqendrohen më te historitë e grupeve sociale mbizotëruese - ata përqafojnë përherë e më shpesh histori të pakicave apo grupeve të shtypura, të përgjaturara nga rrjedha për shkak të klasës, etnisë, gjinisë apo seksualitetit.

Argumenti im është se të gjithë njerëzit duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga muzetë, se kanë të drejtë t'i përdorin muzetë dhe të shohin veten të paraqitur në muze. Po ashtu, besoj se

muzeu ka përgjegjësi për të luftuar për drejtësi sociale dhe të drejtat e njeriut, duke siguruar mundësi përqasjeje për të gjithë, duke qenë pjesëmarrës aktiv në debatet për të drejtat e njeriut.

Muzetë kanë ndryshuar së tepërmi këto 30 vitet e fundit. Tani janë më të përgjegjshëm nga ana shoqërore nga sa kanë qenë më parë, kur përmbushnin një rol më së shumti akademik, duke tërhequr vetëm një pakicë njerëzish të arsimuar. Ky ndryshim ka ardhur së pari ngaqë forcat e punës nëpër muze në mbarë botën tani janë më të reja e më të shumëllojshme dhe, më së shumti, gra. Sot ka interes më të madh për jetën e komuniteteve dhe historinë, për përfshirjen e bashkësisë dhe për demokracinë. Forcat e punës në muze janë më të vetëdijshme nga ana sociale dhe më të trajnuara se më parë.

Muzetë kanë një rol të rëndësishëm studimor dhe grumbullues, (shpesh) edhe rol ekonomik, sepse ndihmojnë në gjenerimin e turizmit; por kanë edhe një rol shoqëror të fokusuar nga publiku, edukativ, të orientuar nga bashkësia, demokratik, të hapur për debat, të shumëllojshëm e të përgjegjshëm nga ana sociale kjo është e vërtetë në mbarë botën dhe ka qenë e tillë për një brez të tërë.

## Një muze i përgjegjshëm nga ana sociale:

- ka një mision të përgjegjshëm social
- ka një kulturë organizative që respekton dhe dhe lartëson të mësuarit
- i shikon ndryshimet si një gjë e mirë
- ofron përvoja emocionale
- trajton çështje të vështira bashkëkohore
- kërkon në mënyrë aktive njerëz që nuk i përdorin muzetë
- bën kërkime mbi audiencën
- është i lidhur në shkallë të gjerë dhe ka shumë partnerë, të cilët i ofrojnë nxitje, ide, burime, informacione kontakti dhe publik.

Muzeu i të drejtave të njeriut është aty ku shohim një muze të përgjegjshëm nga ana sociale që nis të realizojë potencialin e tij të plotë. Gjuha e muzeut të të drejtave të njeriut përfshin terma si mospranim, viktimizim, intolerancë, përndjekje, racizëm, gjenocid dhe muzeu eksploron e punon për t'i luftuar këto. Numri i këtyre muzeve është në rritje në shumë vende, përfshi Muzeun Ndërkombëtar të Skllavërisë (Liverpool, Mbretëri e Bashkuar), Muzeu i Zonës Gjashtë (Kejp Taun, Afrikë e Jugut), Muzeu i Genocidit Tuol Slang (Phnom Pen, Kamboxhia), Muzeu i Pushtimit të Letonisë (Riga, Letoni), Muzeu i Mbetjeve të Luftës së Vietnamit (Ho Çi Min, Vietnam) Muzeu i Zelandës së Re, Te papa Tongareua (Uellington, Zelandë e Re).

## Përfundime:

- Muzetë mbajnë një përgjegjësi më të madhe shoqërore
- Muzetë “thyejnë heshtjen e së shkuarës” dhe ofrojnë pamje të çështjeve
- Muzetë duhet të punojnë në partneritet
- Duhet të mësojmë të punojmë së bashku me median
- Duhet të përfshijmë bashkësinë
- Roli i objekteve shpesh është i vogël
- Rrezikojmë të shkaktojmë fyerje
- Të drejtat e njeriut janë një terren i vështirë dhe “i kontestuar”
- Financime/kontroll nga shteti/qeveria - a mund të jesh i pavarur?

## Pyetje:

- A munden muzetë të nxisin aktivizmin shoqëror?
- A mund të ndihmojnë muzetë në nxjerrjen para drejtësisë të shkelësve të së drejtave të njeriut?
- A mund të ndihmojnë muzetë në parandalimin e gjenocidit?

## Fjalë kyçe:

Integritet - Humanizim - Respekt - Përfaqësim - Lidhje - Zë - Autoritet - Barazi - Njohuri - Kujtime dhe Harresë... dhe rrezik për të HARRUAR

## Bujtinë dhe Bunker

Nga Endrit Marku | Gjirokastra

Bujtinë dhe Bunker është një projekt ndërkombëtar i hartuar në bashkëpunim mes FH Mainz (Universiteti i Shkencave të Aplikuara) në Mainz, Gjermani dhe universitetit POLIS (Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban) në Tiranë, Shqipëri. Projekti u realizua gjatë verës 2012 në Shqipëri pranë fshatit Tale në Lezhë.

Bunkerët përfaqësojnë ende një temë të nxehët në Shqipëri, si dëshmi të një të shkuare jo dhe aq të bukur për t'u quajtur histori. Në vitet 1970-të dhe 1980-të, mijëra bunkerë të llojeve të ndryshme u vendosën për arsye mbrojtëse nëpër gjithë vendin.



Mundësuar nga Endrit Marku

Megjithëse nuk u përdorën kurrë për qëllimin për të cilin u ngritën, sepse nuk përjetuan kurrë asnjë betejë, prania e tyre nëpër gjithë vendin ishte aq e shtuar sa që i ktheu në një simbol negativ të një prej periudhave më të errëta të historisë së Shqipërisë.

Qindra mijëra të tillë u ngritën në gjithë vendin në pozicione strategjike që sot për ironi përkojnë me vendet më të bukura dhe tërheqëse për turistët. Këto struktura ushtarake janë me tipologji të ndryshme ndonëse vetëm një prej tyre është bërë një tipar gati piktoresk i peizazhit shqiptar. Njësia e fortifikuar me formë gjysmë sferike, ndoshta "personazhi" më i njohur shqiptar në mbarë botën. Stigmatizimi negativ dhe çeliku i çmuar që mbartin, së bashku me vendndodhjet aq tërheqëse për ndërtuesit po ndihmojnë në shkatërrimin e tyre në masë në mbarë territorin. Projekti Bujtina dhe Bunkeri nisi pikërisht gjatë një periudhe delikate, kur rrezikohej një trashëgimi e rëndësishme e Shqipërisë dhe, sigurisht, tipologjia e zgjedhur për projektin ishte bunkeri gjysmësferik i përmendur më lart, që ishte dhe imë i përhapuri, më i famshmi, por edhe më i rrezikuari.

Synimi i projektit ishte të riskicohej dhe rifunksionalizohej një bunker ekzistues i mbetur nga periudha komuniste, duke i ndry-

shuar funksionin e tij parësor nga "mburojë luftarake" në një bujtinë me shtretër dhe mëngjes për turistët shëtitës. Projekti nisi në mars 2012 në Universitetin Polis ku studentët e asistuar nga lektorë shqiptarë dhe gjermanë bënë propozimet e para të dizajnit. Kjo u pasua nga faza e dytë në Mainz, Gjermani, ku fokusi kryesor i grupeve ishte finalizimi dhe hollësitë e projektit. Procesi gjashtëmujor përfundoi me fazën e tretë zbatuese, përsëri në Shqipëri.

Objektivi kryesor i projektit të grupit ishte të gjeneronte vlera përmes mjeteve të dizajnit. Megjithëse ishin të shumtë personat e intriguar nga ideja e ripërdorimit të bunkerëve, njerëzit e zakonshëm i shihnin këto struktura si diçka pa vlerë dhe përpjekshin të pastronin sa më tepër terren që të mundeshin duke i larguar, pasi edhe një copë tokë e lirë konsiderohej me më tepër vlera. Edhe ndërtimi i një mjedisi të ri të brendshëm nuk mjaftonte e nuk do të thoshte më tepër se një bunker i lyer bukur. Prandaj u morën parasysh vlera më pragmatike, funksionale dhe ekonomike, së bashku me vlera më abstrakte, të frymëzuara nga ana estetike dhe hapësinore. Materiali i zgjedhur për projektin ishte druri, miqësor dhe i natyreshëm, në kontrast me betonin e ashpër dhe artificial të bunkerit ekzistues. Materialet e ndryshme paraqesin si nga ana simbolike ashtu edhe funksionale periudhat e ndryshme të bunkerit, krijimin e tij të

parë, në kohën e luftës, dhe rilindjen me një qëllim krejt të ri.

Studentët ishin në gjendje të konceptonin, skiconin dhe ndërtonin vetë një dhomë hoteli plotësisht funksionale brenda bunkerit të vjetër. Patën sukses në përpjekjet e tyre për të krijuar diçka të re dhe origjinale brenda një objekti ekzistues të fortë e të vështirë. Kurse synimi tjetër i projektit, ai i përpjekjes për të paraqitur publikisht tërheqjen e bunkerëve duke përhapur ide që mund të krijojnë terren për një të ardhme më të sigurt për këto specie ndërtimi endemike shqiptare, ishte po aq i suksesshëm. Njerëzit, shqiptarë e të huaj, por edhe mediat, shfaqën interes për këtë projekt të përmbushur nga një grup prej 25 shqiptarësh dhe gjermanësh arkitektësh dhe dizenjuesish të sotëm e të ardhshëm.



Mundësuar nga Endrit Marku

## Muze për të gjithë

Nga Tatjana Mijatović | Prizren

Bashkëpunimi i Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe Fondacionit Stavros Niarkos me Muzeun Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës për “Projektet e Aftësive të kufizuara dhe së drejtës” ndihmoi në hedhjen e hapave të para drejt një mundësie më të mirë shfrytëzimi të njërës prej institucioneve më të vjetra në Bosnje- Hercegovinë.

U realizuan dy projekte:

- Udhërrëfytesa zanor për personat e verbër dhe me aftësi të kufizuara shikimi
- Muzeu në valixhe

**Udhërrëfytesa zanor për personat e verbër dhe me aftësi të kufizuara shikimi**

Hapi i parë ishte kërkimi i të gjitha zgjidhjeve teknike që gjenden sot për të verbrit dhe personat me shikim të dëmtuar në përgjithësi, përmes kërkimit në Internet dhe shqyrtimit të projekteve të ngjashme në muzetë e tjera. Pasi u mbledh një sasi e madhe informacioni, ishte i pashmangshëm një përfundim: “Unë nuk kam ndonjë kriter për të bërë zgjidhjen më të mirë!” Prandaj nisa të informohesha nga ekspertët që punojnë në atë fushë (në bibliotekë dhe në shkollë) për problemet dhe nevojat

e personave të verbër dhe me probleme në shikim. Një nga faktet më të rëndësishme që mësova është se alfabeti Braille mund të lexohet vetëm nga persona që kanë lindur të verbër apo e kanë humbur shikimin në moshë të re, në të kundërt ata quhen individë “të paaftë për të lexuar”. Kjo pati rëndësi kyçe në atë se çfarë u përzgjedh si më e mira.

Synimi i këtij projekti ishte të lejonte vizita të pavarura të personave me shikim të dëmtuar apo të verbër nëpër koleksionet e muzeut në mënyrë që ata të kuptonin se çfarë ishte ekspozuar aty. Kuptimi i nevojave dhe problemeve të tyre më bëri të vetëdijshme se sa të mëdha duhet të ishin ndërhyrjet në një muze që ishte krijuar me gjëra “për të mos u prekur”. Në të njëjtën kohë, u bëra e vetëdijshme se nuk kishte mundësi që të realizohej gjithçka. Duheshin bërë plane dhe ky projekt ishte një bazë e mirë për përmirësime të mëvonshme të cilat mendoj



se do të jenë më të lehta se ky hap i parë. Me qëllim që ta bënim vërtet muzeun tonë një muze për të gjithë, ishte e rëndësishme që të përfshiheshin të gjitha moshat e grupet e vizitorëve të verbër dhe atyre me shikim të dëmtuar dhe për ta bërë këtë ashtu si duhej, të verbrit dhe personat me shikim të dëmtuar u përfshinë në çdo hap të realizimit si “grup kontrolli”. Ata u punësuan të përkthenin materialet në gjuhën angleze dhe të krijonin dosjet zanore numerike për udhërrëfytesin e ardhshëm zanor.

Më në fund, u zgjedh lexuesi i barkodeve “I.D.Mate” si zgjidhja më e mirë dhe më e thjeshtë. Bëhet fjalë për një pajisje “të gjitha- në- një” që mbahet në dorë, lexon barkodin dhe flet duke ndihmuar personat me shikim të dëmtuar ose ata që nuk mund të lexojnë për të identifikuar objektet përmes barkodeve të tyre ose kodit universal të produktit. Duke përdorur teknologjitë numerike të kthimit të tekstit në zë, kjo pajisje u lejon përdoruesve të kuptojnë të dhënat bazë të përshkrimit të produktit së bashku me një varg mesazhesh zanore të regjistruara. Tani kemi vetëm 3 lexues barkodesh sepse muzeu ka 3 departamente. Në rastin e vizitave të shumta, i ndajmë vizitorët në tre grupe me qëllim që ta përjetojnë sa më mirë këtë përvojë. Së bashku me kuratorët dhe konservuesin, bëmë përzgjedhjen e objekteve të muzeut që mund të përbënin koleksionin e prekshëm. Në

departamentin e arkeologjisë, përdorëm objektet e ekspozuara nga koleksionet ekzistuese. Departamenti etnologjik përdori origjinalet nga depoja dhe disa sende të reja që u sollën për këtë qëllim. Problemi më i madh ishte departamenti i historisë së natyrës, sepse e gjithë ekspozita ndodhej “pas xhamave” prandaj na u desh të krijojmë objekte të reja të përshtatshme për t’u prekur, të cilët do të ekspozoheshin pranë origjinaleve. M’u desh t’u kaloja kuratorëve një pjesë të njohurive të mia “të reja”, sepse u duhej të bënin “një histori përshkruese” rreth objekteve të prekshme, për t’u siguruar që të gjithë të kenë mundësi t’i kuptojnë plotësisht ato që janë ekspozuar.

Një nga gjërat më të rëndësishme për të lidhur të gjitha pjesët në një të tërë është krijimi i një harte të hollësishme të prekshme të muzeut me pozicionet e ekspozitave të prekshme dhe krijimi i një udhërrëfytese që mund të lexohet në faqen tonë të Internetit.



Rol të rëndësishëm në krijimin e hartës së preکشme, por edhe që më dha një ide se çfarë mund të bëhet tjetër në të ardhmen, ishte një trajnim për imazhet e preکشme në Institutin Kombëtar Mbretëror për Njerëzit e Verbër në Birmingham, të ofruar nga CHwB. Vetëm pas këtij trajnimi nisa të kuptoja se çfarë është imazhi i mirë i preکشëm dhe nisa të dalloja menjëherë të gjitha gabimet që kisha bërë gjatë krijimit të hartës sime “të bukur e teknikisht korrekte”!

CHwB ofroi pajisjet për të krijuar imazhet e preکشme dhe katër kolegë të mi bashkë me mua u bëmë një trajnim mbi imazhet e preکشme profesionistëve nga 11 muze të ndryshëm nga Rrjeti i Muzeve të Ballkanit.

### Muzeu në valixhe

Ky projekt nisi me trajnimin e kuratorëve E. Shljivo dhe S. Avdiç për të punuar me fëmijët e verbër e me shikim të dëmtuar, duke ndjekur kurse të rregullta në shkollën fillore për fëmijët e verbër dhe ata me shikim të dëmtuar. Faza e parë e projektit ishte përgatitja e ekspozitës shëtitëse “Preke etnologjinë”. Për këtë qëllim u bënë 25 replika të vogla të objekteve aktuale të muzeut, së bashku me një valixhe.

Përzgjedhja u krye nga 4 fusha të ndryshme të koleksionit etnologjik:

- mjete bujqësore dhe transporti
- përpunimi me dorë i tekstilit

- vegla muzikore
- pajisje tradicionale shtëpiake

U hartuan edhe histori të përshtatura për fëmijët mes 6 dhe 14 vjeç lidhur me këto objekte.

Muzeu në valixhe mund dhe është zbatuar në mënyra të ndryshme:

- si seminar edukativ në Muzeun Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës
- si ekspozitë shëtitëse në shkolla dhe qendra të ndryshme në Bosnje-Hercegovinë
- si seminare letërsie dhe arti për fëmijët nga shkollat fillore për të verbrit dhe fëmijët me shikim të dëmtuar krahas fëmijëve me shikim normal.

### Një grup i synuar - Një promovim

Promovimi i të dy projekteve u bë përmes medias (radio, gazeta dhe portale Interneti), përmes paraqitjes së projektit në “Qendrën për personat e verbër dhe me aftësi të kufizuara shikimi” dhe duke informuar shkollat ku u mbajtën seminarët, krahas promovimit kryesor që u mbajt në Muzeun Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se seminarët e mbajtura në shkolla edukojnë vizitorë të ardhshëm “të pavarur” për muzetë.



## Tour de Culture

Nga Enes Toska | Gjikokastra

Tour de Culture është një ngjarje çiklistike jo garuese dhe çlodhëse në Kosovë, e hapur për të gjithë: profesionistë dhe amatorë, të rinj e të vjetër, gra e burra. Kjo ngjarje, e cila u mbajt për të pestin vit me radhë në vitin 2012, është kthyer në një veprimtari tradicionale që tërheq vëmendjen në Kosovë falë mbështetjes së madhe nga bashkitë partnere, entuziastët, mirëbërësit vendas e të huaj dhe, mbi të gjitha, falë pjesëmarrësve të kësaj veprimtarie për pasionin dhe entuziazmin që tregojnë.

Objektivi i përgjithshëm i Tour de Culture është promovimi i trashëgimisë së përbashkët kulturore të Kosovës si mjet pajtimi dhe aset i turizmit kulturor përmes një mënyre më të shëndetshme transporti, e cila luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një kulture të re për lëvizshmërinë urbane në Kosovë.

Objektivat e veçanta të këtij turneu janë:

**Nxitja e trashëgimisë sonë të përbashkët natyrore e kulturore**

- mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe shumëllojshmërisë

kulturore në të gjitha nivelet e shoqërisë.

- promovimi i trashëgimisë kulturore si mjet ekzistence dhe dialogu mes bashkësive
- zbulimi i potencialeve për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor



**Promovimi i transportit të pamotorizuar për një lëvizshmëri më efikase për të gjithë.**

- ndërgjegjësimi mes qytetarëve dhe vendim-marrësve lidhur me rëndësinë e rrugëve më të sigurta dhe itineraret e transportit të pamotorizuar
- promovimi i një mënyre më të shëndetshme jetese dhe rrugëve më të sigurta për përdoruesit e transportit të pamotorizuar
- forcimi i pjesëmarrjes së grave, të rinjve, të moshuarve, fëmijëve dhe njerëzve me paaftësi.

**Promovimi i lëvizjes së përbashkët globale për një klimë më të sigurt në të ardhmen**

- vënia e të drejtave të njerëzve dhe natyrës përmbi të drejtat e ndotësve
- mbështetja e programeve që synojnë energjinë e rinovueshme 100%, çlirim zero të dioksidit të karbonit dhe lënia pas dore e karburanteve fosile
- politika të bazuara në shkencë për t'u kthyer nën 350 ppm







- Rritja e numrit të pjesëmarrësve në turne (nga afro 100 në vitin 2008 në më tepër se 700 në 2012) rritja e interesit të donatorëve vendas e të huaj që mbështesin projektin dhe ndryshimi i zakoneve për të marrë më tepër biçikleta me qira për veprimtari, tregon se njohuritë dhe kuptimi i trashëgimisë kulturore dhe çështjeve të lëvizshmërisë urbane po nguliten ngadalë, por thellë, në vetëdijen e shoqërisë kosovare.
- Tour de Culture është një nismë e Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe Programit Mbështetës të Planifikimit Hapësinor të Bashkisë (MuSSP) në Kosovë nga UN-HABITAT, të financuara nga Suedia. Kjo veprimtari e veçantë, e organizuar çdo vit gjatë muajit shtator në pjesë të ndryshme të Kosovës, mbështetet në sinergjinë e parimeve që rrjedhin nga Ditët Evropiane të trashëgimisë (EHD) dhe Java Evropiane e Lëvizshmërisë (EMW ).



## EKIPI BOTUES

**Botues:** Co-Plan, CHwB

**Titulli:** Seminaret Rajonale të Trashëgimisë 2012-2013  
Libërthi i folësve dhe konspekteve

**Financuar nga:** *Financuar nga: Bashkimi Evropian, si pjesë e projektit rajonal të BE-së “Ballkani Perëndimor - Nga integrimi historik te pjesëmarrja aktive bashkëkohore, Bosnje-Hercegovinë, Shqipëri dhe Kosovë” (kontrata nr. 2011/277-768)*

**Bashkërendues botimi:** Mirian Bllaci

**Dizajni i publikimit:** Sonia Jojić, Besnik Dervishi

**Teksti:** Mirian Bllaci me kontribut nga Lejla Hadžić dhe Diana Walters (Faqe 6, 22, 23)

**Përkthimi:** Taulant Hatia

**Redaktimi:** Nedi Petri, Alketa Sulaj

**Fotografisë:** Jonathan Eaton [Cover] | Ajdin Kamber [ 18, 38, 63 ] | CHwB [ 66 - 67, 78 - 81 ]  
David Perrin [ 28, 37, 39, 40, 45, 77 ] | Kreshnik Merxhani [ 23, 27, 43, 59, 69 ]  
Tatjana Mijatović [ 74 - 75 ]

**Printuar:** Dhjetor 2013

**Qarkullimi:** 200 Kopje



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Europian



CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
KULTURARV UTAN GRÄNSER



Kontrata: 2011/277-768 | Projekti: Ballkani Perëndimor - Nga Integrimi Historik Pjesëmarrja Aktive Bashkëkohore